



KUVENDI MIRATON LIGJIN "PËR DISIPLINËN USHTARAKE NË FA TË RSH"

"Ky projektligj i rëndësishëm ka për qëllim pikërisht forcimin e disiplinës ushtarake, të rendit ushtarak dhe të autoritetit të komandim-kontrollit në FA, për të siguruar misionin e tyre kushtetues sa më mirë"

Fjala e ministres së Mbrojtjes, Mimi Kodheli, dje në Kuvendin e Shqipërisë. Të nderuar kolegë, Mjedisi i ri i sigurisë në të cilin po jetojmë, ka bërë të nevojshëm një sërë ndryshimesh të kornizës ligjore në të cilat veprojnë Forcat tona të Armatosura. Gjatë këtij viti, së bashku me kolegët në Ministrinë e Mbrojtjes, kemi gjetur mbështetjen tuaj maksimale në përshtatjen që po i bëjmë paketës ligjore

që rregullon punën tonë të përditshme. I gjithë ky ndryshim ka pasur në thelb të vet dy faktorë të rëndësishëm. Së pari, kishim të bënim me një paketë ligjore e cila datonte në periudhën 2003-2005. Një dekadë e tërë pa asnjë ndryshim thelbësor, ndonëse Shqipëria në përgjithësi dhe Forcat tona të Armatosura në veçanti kanë evoluuar aq shumë përballë realiteteve me të cilat jemi përballur...

» faqe 4

30 komando shqiptarë nisen në misionin "Resolute Support" në Kabul, Afganistan

» faqe 5

DIREKTIVA

Ministrja Kodheli prezanton Direktivën e Mbrojtjes për 2015

Prioritetet kryesore: Modernizimi, infrastruktura dhe mbështetja logjistike e FA



» faqe 2-3



Vizita

Ministrja e Mbrojtjes Kodheli vizitë zyrtare në Britaninë e Madhe

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli zhvilloi një vizitë zyrtare në Mbretërinë e Bashkuar. Ajo u prit në takim nga homologu i saj britanik, Sekretari i Mbrojtjes, z. Michael Fallon. Dy ministrat e Mbrojtjes biseduan lidhur me marrëdhëniet...

» faqe 5



Ceremonia

Arsino Demiri, shpallet nënoficeri më i mirë i vitit në FA

Tashmë është kthyer në traditë përzgjedhja e nënoficerit më të mirë të vitit në Forcat tona të Armatosura. Për këtë qëllim, në sheshin qendror të garnizonit "Skënderbej" u zhvillua një ceremoni e veçantë. Morën pjesë: shefi i Shtabit të Përgjithshëm...

» faqe 7



INTERVISTA

Rruga jonë drejt integritetit në FA ishte mbi të gjitha rrugë emancipimi

» faqe 8-9

DOSSIER

Ringritja e Flotës Luftarake Detare pas çlirimit të Shqipërisë

faqe 12-13

NATO

NATO njeh meritat e misionit ISAF, kapitull i ri në marrëdhëniet me Afganistanin

faqe 14

Prioritetet kryesore: Modernizimi, infrastruktura dhe mbështetja logjistike e FA

Ministria Kodheli prezanton Direktivën e Mbrojtjes për vitin 2015

Në themel të punës: Lufta kundër korrupsionit dhe forcimi i dinjitetit të ushtarakut të Forcave të Armatosura

Ministria Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, ka prezantuar Direktivën e Mbrojtjes për vitin 2015. Në këtë prezantim ishin të pranishëm: shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, komandantët e Forcave, gjeneralë, drejtorë dhe ushtarakë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FA-së etj.

Më poshtë prezantimi i Direktivës së Mbrojtjes për vitin 2015 nga ministria e Mbrojtjes Mimi Kodheli.

Zoti shef i Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, komandantë të Forcave, komandantë të njërive dhe reparteve të FA, drejtues civilë dhe ushtarakë të Ministrisë së Mbrojtjes,

Gjatë vitit 2014 u realizuan një sërë detyrash dhe u shënuan arritje cilësore për Forcat e Armatosura në të gjitha fushat e veprimtarisë dhe angazhimit të tyre. Ndër më të rëndësishmet për t'u përmendur janë: përmirësimi i legjislacionit; intensifikimi i shkëputjes nga armatimi i vjetër dhe rritja e ndërveprueshmërisë me aleatët; zbatimi i rekomandimeve të dokumentit të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes; implementimi i strukturës së re të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura; pjesëmarrja në operacionet dhe misionet e drejtuara nga NATO dhe BE; përmbushja e kontratave në fushën e modernizimit; kryesimi i Kartës së Adriatikut (A5); vijimi me sukses i procesit të asgjësimit të municioneve të tepërta, pastrimi i poligoneve dhe objekteve; niveli i lartë i realizimit të buxhetit; rritja e transparencës lidhur me shpenzimet publike; lufta kundër korrupsionit dhe shkeljeve ligjore; rritja e integritetit të figurës së ushtarakut dhe përmirësimi i sistemit të arsimit, stërvitjes dhe standardizimit të Forcave të Armatosura.

Ngjarjet me të cilat u përballëm gjatë vitit 2014 duhet të na shërbejnë për të përmirësuar perceptimin dhe reagimin tonë në raport me operacionalitetin, gatishmërinë dhe stërvitjen. Viti 2015 është më ambicioz, për vetë sfidat që rrjedhin nga Samiti i Uellsit, i cili u zhvillua në kushtet e mjedisit të



ri të sigurisë, rrethuar nga një hark destabilizimi dhe dhune që fillon në kufijtë e Evropës Lindore e Kaukazit dhe që vazhdon në Lindjen e Mesme dhe Afrikën Veriore. Konflikti në Ukrainë dhe ndërhyrja ushtarake e Rusisë nënkupton një ndryshim në balancat gjeopolitike në gjithë hapësirën Euro-Atlantike me pasoja për ligjin ndërkombëtar dhe rregullin botëror. Zhvillimet serioze në Ukrainë, si dhe kërcënimi i të ashtuquajturit shtet islamik (ISIL) përbën një rrezik real për vetë rajonin dhe për vendin tonë. Të ndodhur para këtyre sfidave serioze ndaj sigurisë, aleatët në Samitin e Uellsit demonstuan sensin e bashkimit dhe veprimit dhe miratuan vendime të rëndësishme për Aleancën, për të përmbushur tre detyrat thelbësore të saj, të përcaktuara në Konceptin Strategjik të vitit 2010.

Nisur nga ky realitet, në qendër të reformave të mbrojtjes për vitin 2015 të jenë krijimi i kapaciteteve operacionale për përballimin e sfidave të sigurisë dhe mbrojtjes, përmirësimi i infrastrukturës dhe modernizimit, zhvillimi i politikave të nevojshme në fushën e menaxhimit të personelit, transformimi i sistemit arsimor ushtarak, përmirësimi i trajnimit dhe strehimit të ushtarakëve, si dhe eliminimi i korrupsionit nëpërmjet rritjes së transparencës.

Në vijim të arritjeve të deritanishme, në funksion të realizimit të misionit kushtetues të Forcave të Armatosura, detyrimeve të vendit tonë ndaj NATO-s, programit të qeverisë në fushën e mbrojtjes dhe objektivave që rrjedhin nga dokumenti i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, ju paraqes:

Prioritetet kryesore për vitin 2015

- Rritja e ndër-veprueshmërisë dhe operacionalitetit
- Modernizimi i mëtejshëm i Forcave të Armatosura
- Përmirësimi i infrastrukturës
- Mirëmenaxhimi i burimeve të mbrojtjes
- Standardizimi i arsimit dhe stërvitjes

Drejtimet kryesore të punës për vitin 2015

Modernizimi, infrastruktura dhe mbështetja logjistike

Prioriteti kryesor në këtë fushë të vijojë të mbetet plotësimi i kapaciteteve të strukturave të Forcave të Armatosura, të cilat do të jenë të gatshme për pjesëmarrjen në operacionet e drejtuara nga NATO, si dhe atyre për përballimin e situatave të jashtëzakonshme, brenda dhe jashtë vendit. Ministria e Mbrojtjes,

REFORMAT

Në qendër të reformave të mbrojtjes për vitin 2015 do të jenë krijimi i kapaciteteve operacionale për përballimin e sfidave të sigurisë dhe mbrojtjes, përmirësimi i infrastrukturës dhe modernizimit, zhvillimi i politikave të nevojshme në fushën e menaxhimit të personelit, transformimi i sistemit arsimor ushtarak, përmirësimi i trajnimit dhe strehimit të ushtarakëve, si dhe eliminimi i korrupsionit nëpërmjet rritjes së transparencës

Shtabi i Përgjithshëm të përqendrohen në realizimin e Objektivave të Kapaciteteve. Fokusi kryesor të vihet tek:

- Batalioni i Dytë i Këmbësorisë së Motorizuar (b2kmot). Zhvillimi i këtij batalioni të vazhdojë të konsiderohet parësor nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Forca Tokësore, duke u reflektuar në të gjitha planet e ristrukturimit, modernizimit, trajnimit dhe stërvitjes për vitin 2015. Në qendër të vëmendjes të këtij batalioni të jetë kompania e parë e këmbësorisë e cila përgatitet dhe certifikohet për Operacionet e Reagimit të Shpejtë të NATO-s (NRF).

- Zëvendësimi gradual i armatimit të vjetër me armatimin sipas standardeve të NATO-s. Shtabi i Përgjithshëm dhe strukturat përkatëse në Ministrinë e Mbrojtjes të hartojnë planet afatgjata për kalimin gradual drejt armatimit dhe municioneve perëndimore në përputhje të plotë me standardet e NATO-s.

- Përfundimi i projektit të helikopterëve dhe anijeve patrulluese. Të vijojë ndjekja e projektit të modernizimit me helikopterë EC-145; të zhvillohen kapacitetet SAR; të vijojë puna për Integrimin në Sistemin e Integruar të Mbrojtjes Ajrore dhe Raketore të NATO-s (NATINAMDS) dhe të implementohet projekti ASBE.



• Infrastruktura të përmirësohet duke përqendruar investimet në krijimin e kushteve sa më optimale për realizimin e misionit të kërkuar, si dhe për përmirësimin e jetesës së personelit të Forcave të Armatosura. Prioritet në këtë drejtim të ketë përgatitja e master-planeve për të gjitha garnizonet kryesore në përputhje me planin e përhapjes dhe normalizimi i kushteve të punës në njësitë prioritare në bazë të Planit Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2015-2025. Infrastruktura e poligoneve të stërvitjes të synojë ndërtimin e poligoneve të reja si dhe rikonstruksionin e atyre ekzistuese, duke krijuar kushte bashkëkohore për përgatitjen e efektivave.

- Trajtimi i pronave të tepërta të cilat dalin jashtë Planit të Vendosies dhe Përhapjes të Forcave të Armatosura të vazhdojë edhe gjatë vitit 2015, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, me rifreskimin e listës së pronave të dala të lira nga ristrukturimi i FA dhe publikimin e pronave që do t'i nënshtrohen procesit të privatizimit në faqen zyrtare të MM në kuadër të transparencës me publikun. Të vazhdojë puna për regjistrimin, transferimin, pajisjen me certifikatë pronësie, privatizimin dhe dhënien e tyre me qira.

- Mbështetja logjistike dhe mjekësore e strukturave të Forcave të Armatosura të sigurohet përmes zbatimit të një sistemi të integruar të mbështetjes logjistike dhe mjekësore. Të vijojë puna për implementimin e projekteve të automatizimit logjistik.

Pjesëmarrja aktive në operacione brenda dhe jashtë vendit

Të vazhdojë rritja e bashkëpunimit civilo-ushtarak në operacionet dhe misionet brenda vendit, kryesisht për përballimin e emergjencave civile dhe dhënien e ndihmës ndaj komunitetit civil, si dhe pjesëmarrjes në operacione të mundshme të stabilizimit dhe rindërtimit, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse në vend si Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve të Brendshme, etj. Përmirësimi i vazhdueshëm i imazhit të Forcave tona të Armatosura dhe dhënia e një kontributi të qenësishëm ndaj këtij komuniteti të vazhdojë të jetë motivi kryesor i veprimtarisë së FARSH për periudhën në



vazhdim.

Të vazhdojë puna për vënien në efikasitet, zhvillimin dhe konsolidimin e Qendrës Kombëtare të Kërkim Shpëtimit, bazuar në detyrimet ligjore, me theks kryesor, përgatitjen e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit, në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse brenda vendit, si dhe në kuadrin e bashkëpunimit rajonal.

Gjatë vitit 2015, Forcat e Armatosura të planëzojnë e të marrin pjesë në misionin “Resolute Support” të NATO-s në Afganistan, në përputhje me nivelin e ambicies kombëtare dhe kërkesat e NATO-s, si dhe të kontribuojnë në misionin e BE-së, në Mali (EUTM MALI) me instruktorë EOD.

Niveli i përfqësimit në KFOR, Kosovë të pësojë rritje, ndërsa në ALTHEA, Bosnje – Hercegovinë të ruhet, duke e vënë theksin në rritjen e cilësisë së pjesëmarrjes. Në kuadër të “Readiness Action Plan të NATO-s, nën parimin 28*28 të Aleancës, të planëzohen kontribute me personel ushtarak/civil, në përputhje me vendimet politike dhe kërkesat operacionale të Komandantit të Aleancës për Operacionet (SACEUR), si dhe të rritet pjesëmarrja në kuadër të stërvitjeve kolektive.

Menaxhimi i Burimeve të Mbrojtjes

Të finalizohet harmonizimi i plotë i planifikimit kombëtar të mbrojtjes me Procesin e Planifikimit të Mbrojtjes së NATO-s (NDPP). Te vijojë reforma e personelit, nëpërmjet përmirësimit të politikave dhe procedurave duke vënë theksin tek intensifikimi i masave për rritjen e përkujdesjes sociale ndaj

ushtarakëve.

- Motivimi i personelit nëpërmjet përmirësimit të trajtimit financiar, strehimit, kushteve të punës, trajtimit me ushqim e veshmbathje dhe vendosjes së një sistemi të drejtë të përparimit në karrierë dhe detyrë, ka qenë dhe do të jetë një konstante e pandryshuar e punës time si Ministre e Mbrojtjes.

- Standardizimi i Arsimit dhe Stërvitjes janë thelbësore për krijimin e kapaciteteve të afta për t'u përballur me sfidat globale të sigurisë. Të krijohet Libri i Programeve Stërvitore në nivel Force të Armatosur, të ndërtohen programe stërvitore me fokus të veçantë trajnimit të personelit në mbrojtjen kolektive dhe menaxhimin e krizave dhe të planëzohen stërvitjet kombëtare në përputhje me ciklin e planëzimit të NATO-s. Vëmendja kryesore të përqendrohet në arsimimin individual institucional dhe funksional brenda dhe jashtë vendit në bazë të planeve vjetore të bashkëpunimit dypalësh, rritjes së kapaciteteve gjuhësore, të treguesve të aftësive fizike individuale të ushtarakëve të FA, si dhe përgatitjes së oficerit të ri, brenda dhe jashtë vendit.

- Të rishikohet Strategjia e Zhvillimit të Burimeve Njerëzore dhe plani i zbatimit të saj (2011–2015). Të evidentohej të gjitha specialitetet që rrezikohen dhe të propozohen masa konkrete për adresimin e tyre. Theks i veçantë t'i kushtohet ngritjes së kapaciteteve në fushën e Mbrojtjes Kibernetike, të Inteligjencës dhe Sigurisë

- Gjatë vitit 2015 të përmbushen të gjitha angazhimet dhe deklarimet mbi trajnimet dhe përgatitjet e kapaciteteve në kuadër të deklarimeve të vendit tonë



në “Forcën e Reagimit të NATO-s” (NRF-2016). Të plotësohen të gjitha detyrimet për pjesëmarrjen në Stërvitjen e NATO-s “Trident Juncture 2015” dhe në stërvitjen rajonale shumëkombëshe “Joint Reaction 2015”. Gjithashtu, të merren të gjitha masat për zhvillimin e kapaciteteve duke përdorur më së miri iniciativat e “Smart Defense”, “Connected Forces Initiative” dhe “Frameöork Nations Concept”, si dhe projekteve të tjera të përbashkëta në kuadër të iniciativave aktuale apo të reja të Aleancës që shkojnë drejt krijimit të “NATO Forcës 2020”. Të përafrohen procedurat për konceptin e zgjeruar të trajnimeve të NATO-s për periudhën 2015-2020 dhe programin e stërvitjeve kryesore të NATO-s nga viti 2016 e në vazhdim.

- Menaxhimi Financiar. Të rritet eficaenca në menaxhimin e buxhetit të mbrojtjes, përcaktimin e prioritetëve, programimin dhe hartimin e projekteve, përdorimin efikas të burimeve të brendshme të MM (të ardhurat dytësore), për të realizuar prioritetet e vendosura. Të forcohet bashkëpunimi midis të gjitha strukturave të MM/SHP, dhe përfaqësive tona jashtë me qëllim rritjen e mundësisë të përfuturit të projekteve të financuara nga fondet e përbashkëta të NATO-s dhe thithjen e donacioneve.

Përmirësimi i legjislacionit

Të vazhdojë reforma ligjore, për rishikimin e të gjitha akteve që rregullojnë veprimtarinë e Forcave të Armatosura, hartimin e projekt-akteve ligjore në përputhje me zhvillimet dhe reformat në fushën e mbrojtjes, si dhe nxjerrja e të gjitha akteve të nevojshëm nënligjore në zbatim të tyre.

Demontimi i municioneve të tepërta

Të vijojë procesi i demontimit në sasi të reduktuara edhe gjatë vitit 2015. Rëndësi e veçantë t'i kushtohet mbikëqyrjes të pastrimit dhe reha-



Motivimi i personelit nëpërmjet përmirësimit të trajtimit financiar, strehimit, kushteve të punës, trajtimit me ushqim e veshmbathje dhe vendosjes së një sistemi të drejtë të përparimit në karrierë dhe detyrë, ka qenë dhe do të jetë një konstante e pandryshuar e punës time si Ministre e Mbrojtjes.

bilitimit të poligoneve dhe hot-spoteve në territorin e vendit si dhe rritjes së sigurisë të grumbullimeve/depove të armatim/municionit. Synimi i zbatimit të programeve për asgjësimin e municioneve, të jetë krijimi i një mjedisi të sigurt në vend, rajon e më gjerë. Në bazë të suksesit të projektit-pilot të demontimit me Malin e Zi të studiohen mundësi të tjera për projekte të ngjashme me vendet e rajonit. Të merren masat e nevojshme për të lehtësuar Forcat e Armatosura nga municionet e tepërta, reduktimin e numrit të personelit të ruajtjes, mirëmbajtjes, administrimit dhe menaxhimit të municioneve në objektet e Forcave të Armatosura si dhe liçensimi i depove të municioneve sipas



standardeve të NATO-s.

Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes

Fokusi kryesor i bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë do të jetë në implementimin e kërkesave që rrjedhin si vend anëtar i NATO-s, në realizimin e detyrimeve që duhen përmbushur në kuadër të përpjekjeve për anëtarësimin e vendit në BE, në iniciativat dhe marrëveshjet rajonale dhe dypalëshe. FA dhe strukturat e saj të kontribuojnë në kuadër të platformës së Iniciativës së Ndërveprimit me Partnerët, në ndërtimin dhe përmirësimin e kapaciteteve të mbrojtjes, kryesisht në fushat e këshillimit, asistencës, standardizimit, edukimit, trajnimit dhe stërvitjeve të përbashkëta. Të rritet roli aktiv në të gjitha iniciativat strukturat, komitetet dhe grupet e punës së NATO-s dhe mbështetja për të gjitha misionet dhe operacionet ndërkombëtare.

Në kuadrin e bashkëpunimit me

BE-në dhe detyrimet për realizimin e kërkesave që rrjedhin nga procesi i Integritetit të vazhdojë pjesëmarrja aktive në Operacionet e Mbështetjes së Paqes. Të ndiqen detyrimet që burojnë nga Politika Evropiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes, e Kufijve të Jashtëm, Lufta Kundër Terrorizmit dhe Përafrimit të Legjislacionit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Bashkëpunimi me OSBE-në të përqendrohet në realizimin e marrëveshjeve për eliminimin e kimikateve të tepërta, hot-spoteve, armëve të vogla dhe të lehta, si dhe realizimin e detyrimeve në kuadër të Armë-Kontrollit dhe raporteve periodike që përgatiten për këtë qëllim. Gjithashtu, të merret parasysh bashkëpunimi edhe në fushat e perspektivës gjinore dhe në rritjen e efikasitetit dhe transparencës në institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes.

Bashkëpunimi rajonal, të frymëzohet nga përgjegjësia jonë si një vend anëtar i NATO-s dhe të fokusohet në ruajtjen dhe konsolidimin e stabilitetit në rajon e veçanërisht në Ballkanin Perëndimor, duke e thelluar bashkëpunimin në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Bashkëpunimi rajonal të ketë si objektiv anëtarësimin sa më të shpejtë të vendeve të Ballkanit Perëndimor në NATO dhe BE. Bashkëpunimi me Republikën e Kosovës të synojë përshtetimin e procesit integruar në strukturat euroatlantike dhe të mbështesë pjesëmarrjen e Kosovës si partner të barabartë me shtetet e tjera pjesëmarrëse në iniciativat dhe takimet rajonale në kuadër të Kartës së Adriatikut, SEDM, etj.

Në kuadrin e bashkëpunimit dypalësh të përforcohet partneriteti strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, marrëdhëniet e konsoliduara dhe

strategjike me partnerët tanë anëtarë të NATO-s dhe BE-së, si dhe të avancojë bashkëpunimin me partnerë të tjerë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Bashkëpunimi dypalësh të ketë si fokus rritjen e numrit të aktiviteteve të përbashkëta dhe cilësinë e përfaqësimit.

Në themel të punës, si bosht mbështetës për realizimin me sukses të kësaj Direktive gjatë vitit 2015 do të jetë lufta pa kompromis kundër korrupsionit dhe përpjekja maksimale për forcimin e imazhit e dinjitetit të personelit të Forcave të Armatosura.

Si ministre e Mbrojtjes, në zbatim të kësaj direktive, kërkoj nga Shtabi i Përgjithshëm, Komandantët e Forcave dhe Njësitë, strukturat vartëse, drejtoritë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të detajojnë plane e programe konkrete veprimi në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga kjo direktivë, si dhe të marrin të gjitha masat për realizimin në kohë e me cilësi të tyre.

Fjala e ministres së Mbrojtjes, Mimi Kodheli, në Kuvendin e Shqipërisë

Kuvendi miraton ligjin “Për Disiplinën Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”

“Ky projektligj i rëndësishëm ka për qëllim pikërisht forcimin e disiplinës ushtarake, të rendit ushtarak dhe të autoritetit të komandim-kontrollit në FA, për të siguruar misionin e tyre kushtetues sa më mirë”

Kuvendi i Shqipërisë diskutoi dhe miratoi ligjin për “Për Disiplinën Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Fjala e ministres së Mbrojtjes, Mimi Kodheli, dje në Kuvendin e Shqipërisë

Të nderuar kolegë,

Mjedisi i ri i sigurisë në të cilin po jetojmë, ka bërë të nevojshëm një sërë ndryshimesh të kornizës ligjore në të cilat veprojnë Forcat tona të Armatosura. Gjatë këtij viti, së bashku me kolegët në Ministrinë e Mbrojtjes, kemi gjetur mbështetjen tuaj maksimale në përshtatjen që po i bëjmë paketës ligjore që rregullon punën tonë të përditshme. I gjithë ky ndryshim ka pasur në thelb të vet dy faktorë të rëndësishëm. Së pari, kishim të bënim me një paketë ligjore e cila datonte në periudhën 2003-2005. Një dekadë e tërë pa asnjë ndryshim thelbësor, ndonëse Shqipëria në përgjithësi dhe Forcat tona të Armatosura në veçanti kanë evoluar aq shumë përballë realiteteve me të cilat jemi përballur. Një forcë ushtarake anëtare e NATO-s që operonte në ngërçe kohore dhe konceptuale.

Dhe së dyti, për shkak të keqpërdorimit të ligjit, sistemi ishte shndërruar në një instrument që operonte të paktën gabimisht për shkak të boshllëqeve të mëdha të krijuara.

Sot kemi sjellë përpara jush, projektligjin “Për Disiplinën Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Jemi përpjekur të forcojmë disiplinën bazuar në eksperiencat më të mira të vendeve aleate, duke mos harruar respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Ky projektligj i rëndësishëm ka për qëllim pikërisht forcimin e disiplinës ushtarake, të rendit ushtarak dhe të autoritetit të komandim - kontrollit në Forcat e Armatosura, për të siguruar misionin e tyre kushtetues sa më mirë. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i normave dhe rregullave të hollësishëm të sjelljes e të etikës së ushtarakëve të FA, i kategorive dhe llojeve të shkeljeve, masave disiplinore si dhe i autoriteteve kompetente për dhënien e tyre. Përmes këtij projektligji nuk po rrisim apo forcojmë dënimet ndaj ushtarakëve, por po shtojmë dhe forcojmë integritetin e burrave dhe grave në uniformë në Republikën e



Shqipërisë.

Me shprehjen pozitive të vullnetit tuaj ndaj këtij qëllimi dhe në raport me këtë projektligji, Qeveria Shqiptare dhe Ministria e Mbrojtjes i hapin rrugën adresimit, përmirësimit dhe ndryshimit të të gjitha mangësive që kanë cenuar integritetin e Forcave të Armatosura.

Risiti e këtij projektligji janë të shumta dhe nisin që nga forma, e cila është e përshtatur me të gjitha normat e sotme të teknikës legjislativë dhe deri tek përmbajtja e tij. Në projektligj janë trajtuar fillimisht objekti, subjektet, qëllimi, juridiksioni dhe autoritetet përgjegjëse për dhënien e këtyre masave disiplinore. Më pas janë trajtuar llojet e shkeljeve disiplinore, llojet e masave dhe ndarjet e tyre. Ligji mbyllet me aspektet procedurale si ecuria disiplinore, rrethanat rënduese/ lehtësuese, pezullimi, parashkrimi, rehabilitimi dhe në fund animimi.

Për të shmangur konfuzionin e krijuar nga praktikat e ndjekura me ligjin

e vjetër, në përcaktimin e autoriteteve përgjegjëse për dhënien e masës disiplinore konkrete, këto autoritete janë detajuar në mënyrë të imtësishme duke eliminuar formulimet e përgjithshme.

Autoritetet në këtë rast janë Presidenti i Republikës (në cilësinë e Komandantit të Përgjithshëm të FA), Kryeministri, Ministri i Mbrojtjes, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, komandantët e forcave dhe strukturave mbështetëse, komandantët në nivel batalioni dhe komandantët në nivel kompanie.

Ligji i vjetër parashikonte një numër tepër të kufizuar shkeljesh dhe masash disiplinore të cilët në fakt e kufizonin edhe aplikimin e tij. Autoritetet përgjegjëse për dhënien e masave gjendeshin përpara pak alternativave të cilat ishin shumë të lehta ose shumë të rënda, pra nuk përputheshin me pjesën më të madhe të situatave të paraqitura, të cilat padyshim kërkonin zgjidhje. Ndër shkeljet e reja disiplinore të parashikuara mund të përmendim:

- Shkelje disiplinore me karakter politik, si mbështetja e fushatës së një partie ose organizate politike;
- Shkelje disiplinore që cenojnë figurën e ushtarakut
- Shkelje disiplinore në lidhje me mbajtjen dhe përdorimin e armëve
- Shkelje disiplinore në lidhje me administrimin e informacioneve,
- Shkelje disiplinore të tjera me objekte të ndryshme ngacmimet seksuale, një shkelje shumë e ndjeshme e cila gjendet e shkruar në të gjitha ligjet e disiplinës të vendeve anëtare të NATO-s;
- Për sa i përket masave disiplinore ato janë ndarë në të lehta, të rënda dhe shumë të rënda.
- Masat për shkeljet e lehta janë “qortim”, detyra shtesë”, “punë jashtë orarit”.
- Masat për shkeljet e rënda janë “vërejtje me shkrim”, “kufizimi i lëvizjes në kufij të përcaktuar”, “ndalim disiplinor” dhe “gjobitje në pagë”.

Masat për shkeljet shumë të rënda janë “vërejtje me paralajmërim” dhe “lirimi nga Forcat e Armatosura”.

Është pasur kujdes që autoriteti i cili jep masën për libër nga FA, të jetë i njëjtë me autoritetin i cili ka kompetencën për emërimin e ushtarakëve në FA, pasi dhe konceptualisht, autoriteti i cili bën emërimin ka dhe kompetencën për të liruar një ushtarak nga FA.

Për shkak të nivelit të lartë të funksioneve që kryejnë dhe pozitive që zënë në hierarkinë ushtarake, i niveleve të ndryshme të gradave në FA, masat që mund të jepen ndaj ushtarakëve në gradë madhore do të jenë vetëm vërejtja me paralajmërim dhe largimi nga FA dhe këtu bëhet i vetmi dallim midis ushtarit të thjeshtë dhe ushtarakut me gradë madhore. Në të gjitha rastet e tjera ky ligj është i zbatueshëm nga ushtari i thjeshtë deri tek shefi i Shtabit të Përgjithshëm, të cilët të gjithë bashkë janë të detyruar të ndjekin dhe të zbatojnë pikërisht këtë ligj. Thëksojmë se këto masa janë sa normale aq edhe të zakonshme për të gjitha vendet anëtare të NATO-s. Për herë të parë janë futur dhe konceptet e rrethanave lehtësuese dhe rënduese si dhe pezullimi disiplinor, koncepte këto të huazuara nga Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

Së fundi medoj që masat e dhëna për shkelje të rënda dhe shumë të rënda si nga Shefi i SHPFA dhe për masa e dhëna nga Ministri i Mbrojtjes, Kryeministri dhe Presidenti i Republikës, është përcaktuar dhe e drejta e ankimit të drejtpërdrejtë në gjykatë. Një zgjidhje e tillë është bërë pasi masat ndaj ushtarakëve të FA në këto raste jepen nga autoritetet më të larta të hierarkisë së drejtimit dhe komandimit strategjik të FA, siç janë Shefi i SHPFA, Ministri i Mbrojtjes, Kryeministri dhe Presidenti dhe për pasojë ankimi administrativ në një organ epror ndaj tyre nuk ka kuptim. Ankimi drejtpërdrejt në gjykatë vetëm për këto raste është parë si zgjedhja më e përshtatshme dhe e drejtë për sa i përket të drejtës së ushtarakëve për t’u ankimuar ndaj një vendimi të dhënë në raport me ta.

Të nderuar kolegë,

Duke ju ftuar që të votojmë këtë projektligji, ju falënderoj realisht për kontributin tuaj në gjithë përgatitjen dhe miratimin e paketës ligjore që ndihmon në veprimtarinë e saj si Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë ashtu dhe Ministrinë e Mbrojtjes.

Ministrja e Mbrojtjes Kodheli vizitë zyrtare në Britaninë e Madhe

Ministrja Kodheli: Jam këtu për t'iu përcjellë mesazhin se te Shqipëria do të gjeni një aleat të mirë. Ne duam që të thellojmë më shumë bashkëpunimin mes dy vendeve tona, sidomos në fushën e mbrojtjes

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli zhvilloi një vizitë zyrtare në Mbretërinë e Bashkuar. Ajo u prit në takim nga homologu i saj britanik, Sekretari i Mbrojtjes, z. Michael Fallon. Dy ministrat e Mbrojtjes biseduan lidhur me marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Britanisë së Madhe në fushën e mbrojtjes. Zonja Kodheli vuri theksin në rëndësinë që ka forcimi i bashkëpunimit mes Forcave të Armatosura të të dy vendeve. “Jam këtu për t'iu përcjellë mesazhin se te Shqipëria do të gjeni një aleat të mirë. Ne duam që të thellojmë më shumë bashkëpunimin mes dy vendeve tona, sidomos në fushën e mbrojtjes”, - është shprehur ministrja e Mbrojtjes e Shqipërisë, znj. Mimi Kodheli.

Gjithashtu, ministrja Kodheli e njohu homologun e saj britanik me ndërtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve ushtarake nga ana e Shqipërisë, si dhe me paketën e modernizimit të Forcave të Armatosura. “Bashkëpunimi aktual në arsimimin dhe trajnimin e ushtarakëve shqiptarë në Britani është i shkëlqyer, - ka nënvizuar zonja Kodheli, - dhe shpresojmë të vazhdojmë në këtë rrugë pasi modeli juaj është ai i duhuri”.

Më pas, dy ministrat e Mbrojtjes u ndalën në zhvillimet pas Samitit të Uellsit, duke u fokusuar kryesisht te kriza në Ukrainë dhe konflikti në Siri e Irak me të ashtuquajturin shtet islamik. Të dy ministrat shprehën nevojën e intensifikimit të shkëmbimit të informacionit mes dy vendeve për sa i përket luftëtarëve të huaj në këto konflikte dhe kriza. Duhet



theksuar se, kontributi shqiptar në luftën kundër shtetit islamik u vlerësua fuqishëm nga sekretari britanik i Mbrojtjes, z. Michael Fallon. Në këtë

kontekst, zonja Kodheli falënderoi palën britanike për ndihmën e dhënë në transportimin e armëve dhe municioneve që Shqipëria kontribuoi në ndihmë të

qeverisë së Irakut.

Po kështu, të dy autoritetet e larta vlerësuan stërvitjet e përbashkëta mes Forcave të Armatosura të dy vendeve dhe diskutuan idenë e vazhdimet të formatit të stërvitjes “Abanian Lion” edhe në të ardhmen. Gjatë qëndrimit në Londër, ministrja e Mbrojtjes Kodheli u takua edhe me personalitete të tjera në Ministrinë Britanike të Mbrojtjes, si dhe në Ministrinë e Jashtme. Në fokus të këtyre takimeve ishte nevoja për intensifikimin e përpjekjeve të përbashkëta përballë sfidave të reja që po përballlet Aleanca. Si në takimin me ministrin për Forcat e Armatosura, z. Julian Brazier, ashtu dhe me drejtorin e Mbrojtjes dhe Sigurisë në Ministrinë e Jashtme, z. Peter Jones, u vu theksi tek vendosja dhe forcimi i standardeve për një Forcë të Armatosur që t'i përgjigjet sfidave të kohës.

Zonja Kodheli mbajti dhe një leksion në Institutin Mbretëror të Shërbimeve të Bashkuara (Royal United Service Institute, RUSI), ku në fokus ishin sfidat e vendeve të Ballkanit Perëndimor përballë krizave në Ukrainë dhe në Lindjen e Mesme. Ministrja e Mbrojtjes Kodheli mori pjesë gjithashtu në ceremoninë e graduimit të kadetëve ushtarakë në Akademinë Mbretërore Ushtarake të Sandhurstit. Kadetja shqiptare, Albana Stori, përfundoi me sukses ciklin e edukimit për vitin 2014. Gjatë kësaj ceremonie, zonja Kodheli u takua edhe me personalitete të tjera ndërkombëtare, si ministrja gjermane e Mbrojtjes, znj. Ursula von der Leyen.

30 komando shqiptarë nisen në misionin “Resolute Support” në Kabul, Afganistan

Ministrja Kodheli: Ju, komando shqiptarë, do të angazhoheni në kuadër të misionit “Resolute Support”, krah për krah aleatëve dhe partnerëve tanë në ndërtimin e një bote më të sigurtë për ne dhe fëmijët tanë

Në mjesditet e Komandës së Forcës Ajrore në Rinas është zhvilluar ceremonia e nisjes për në Kabul, Afganistan, të kontingjentit të Batalionit Komando të Forcës Tokësore, i cili do të veprojë në kuadër të misionit “Resolute Support”.

Për përcjelljen e 30 trupave komando në këtë mision ishin të pranishëm ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, ambasadori i Republikës së Turqisë në Tiranë, z. Hidayet Bayraktar, ushtarakë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FA, familjarë dhe të afërm të ushtarakëve që nisen me mision etj.

Ceremoninë e hapi komandanti i Batalionit Komando, nënkolonel Besim Bala.

Ministrja e Mbrojtjes Kodheli, duke përshëndetur trupat e kontingjentit të ri paqeruajtës në Kabul të Afganistanit, theksoi se kontingjenti juaj është në vijim të rreth 22 kontingjenteve shqiptare të dërguara që nga viti 2002. Së bashku me aleatët tanë, ne po hapim një fazë të re angazhimi në Afganistan, me qëllim mbështetjen e qeverisë së Kabulit në përpjekjet e saj për forcimin e stabilitetit dhe ngritjen e sigurisë në vend.



Ju, komando shqiptarë, do të angazhoheni në kuadër të misionit “Resolute Support”, krah për krah aleatëve dhe

partnerëve tanë në ndërtimin e një bote më të sigurtë për ne dhe fëmijët tanë. Simbolika është e veçantë, pikërisht

nga reparti juaj u nis misioni i parë drejt Afganistanit në vitin 2002, në kuadër të misionit ISAF. Edhe kësaj radhe janë po trupat komando që hapin siparin e angazhimit shqiptar në kuadër të misionit “Resolute Support”.

Më tej, ministrja Kodheli tha se, ju do të rreshtoheni krah për krah ushtarakëve turq, miqve që na kanë mbështetur pa kursim në të gjithë këtë përpjekje tonën për transformim dhe modernizim. Me këtë rast ajo falënderoi Qeverinë dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Turqisë për mbështetjen që kanë dhënë për Forcat tona të Armatosura. Gjithashtu ministrja Kodheli falënderoi prindërit, bashkëshortet, fëmijët, motrat dhe vëllezërit e trupave të këtij kontingjenti për mbështetjen që i japin

atyre për kryerjen me nder të këtij misioni. “Ju të gjithë do t'ia dilni kësaj sfide, sepse jeni zgjedhur nga atdheu juaj për ta përfaqësuar atë, por edhe sepse ne si qeveri do të bëjmë gjithçka për t'iu mbështetur, do t'iu japim pajisjet më të mira që kemi, do të përkujdesemi për familjet tuaja dhe do t'iu përmbushim çdo premtim të bërë. Jam krenare e ju uroj rrugë të mbarë dhe djem si ju paçim gjithmonë”, - ka përfunduar përshëndetjen e saj ministrja e Mbrojtjes Kodheli. Në këtë ceremoni përshëndeti edhe ambasadori i Republikës së Turqisë në Tiranë, z. Hidayet Bayraktar.

Më pas, ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, i ka dorëzuar flamurin kombëtar, komandantit të kontingjentit, kapiten Melsi Hysaj.



Gjeneralmajor Bazo jep dhurata për personat me aftësi të kufizuar

Personat me aftësi të kufizuar në Qendrës Rezidenciale “Pëllumbat” sot kanë pasur një ditë ndryshe nga të tjerat. Mes tyre ishte shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, i cili u shpërndau atyre dhurata për festat e fundvitit. Këto dhurata janë përgatitur nga personeli i Forcave të Armatosura enkas për personat me aftësi të kufizuara të Qendrës Rezidenciale “Pëllumbat” projektit “Shërbimi Social Inovativ” të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Në këtë aktivitet ishte i pranishëm edhe ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, z. Erion Veliaj.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Jeronim Bazo, vlerësoi punën e Ministrisë së Mirëqenies dhe Rinisë me brezat e rinj për integrimin e tyre dhe kthimin në një forcë punëtore të specializuar dhe të vlefshme për tregun e punës dhe Shqipërinë, por edhe për shërbimin social në mbështetje dhe ndihmë të shtresës më në nevojë të shoqërisë. Gjeneralmajor Bazo theksoi se, heronjtë



nuk janë vetëm ata që luftojnë e bien në fushëbetejë, por edhe ata mësues, kujdestarë e vullnetarë, të cilët me dashuri, humanizëm dhe profesionalizëm i shërbejnë kësaj shtrese të shoqërisë sonë.

Me këtë rast, ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Erion Veliaj, falënderoi gjeneralmajor Jeronim Bazon, për këtë aktivitet festiv, por me vlera të pamasave sociale. Ai vlerësoi gjithashtu kontributin e Forcave të



Armatosura, sidomos vitet e fundit, të cilat përveç kryerjes me nder të detyrave dhe misionëve të saj ushtarake brenda dhe jashtë vendit, ka qenë në krye të aksioneve të emergjencave civile, sensibilizimit qytetar, por edhe

ato sociale, siç është edhe ky aktivitet. Në fund të aktivitetit u shpërndanë dhurata për personat me aftësi të kufizuar në këtë qendër, si dhe u zhvillua një program muzikor për të pranishmit.

Takim me përfaqësueset e shoqatës “Gratë në Institucionet e Sigurisë së Kosovës”

Në vijim të punës dhe progresit të bërë në Forcat tona të Armatosura në fushën e perspektivës së barazisë gjinore dhe të zbatimit të detyrimeve që vijnë në kuadër të OKB dhe NATO-s, por edhe të strategjive shtetërore në këtë fushë, në Ministrinë e Mbrojtjes u zhvillua një aktivitet bashkëpunimi me grupin e përfaqësuesve të shoqatës “Gratë në Institucionet e Sigurisë së Kosovës”. Ky grup kryesohej nga presidentja e kësaj shoqate, kolonele Taibe Cenolli. Grupi me përbërje ndërinstytucionale nga institucionet e sigurisë së Kosovës, si Ministria e FSK, Ministria e Punëve të Brendshme, Shërbimi Korrektues dhe Dogana e Kosovës, u prit nga drejtoresha e Drejtorisë së Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak në Shtabin e Përgjithshëm, kolonele Manushaqe Shehu.

Në këtë takim, që u karakterizua nga një frymë tepër miqësore, u diskutuan mjaft çështje kryesisht të fokusuar në fushën e perspektivës gjinore. Çështjet e trajtuara kishin të bënin me

vështirësitë e hasura në pajtimin e jetës familjare dhe rolit të gruas në të, me ecurinë në karrierën ushtarake dhe vendin që ajo zë në FA, duke dhënë realitetet dhe progresin e bërë në këtë drejtim nga të dy vendet. Drejtoresha e BCU-së, kolonele Shehu, evidentoi disa nga arritjet e deritanishme në FARSH, duke theksuar se politikat e çështjeve gjinore shihen në dy drejtime, atë numerik në kuadër të “Gender Balance” dhe në atë cilësor, që ka të bëjë me angazhimin e grave në pozicione kyçe e vendimmarrëse. “Integrimi i femrave në FARSH është një prioritet i politikave dhe strategjive shtetërore dhe leadershipit civil e ushtarak të institucionit të mbrojtjes, i cili tashmë është një realitet”, - është shprehur kolonele Shehu. Ajo evidentoi gjithashtu faktin që trajtimi i kujdesshëm dhe vëmendja e veçantë, kryesisht e ministres së Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, ndaj çështjeve të barazisë gjinore, përfshirja e tyre në dokumentet strategjike kombëtarë dhe ato të institucionit të mbrojtjes,



ka bërë të dukshëm progresin në aspektin e sigurisë gjinore, por njëkohësisht shihet edhe si një motivim për nxitje dhe promovim në karrierë të personelit femëror ushtarak që shërben në Forcat e Armatosura. Presidentja e shoqatës,

“Gratë në Institucionet e Sigurisë së Kosovës”, kolonele Taibe Cenolli, informoi mbi projektin e përbashkët ndërmënisht “Gratë në Institucionet e Sigurisë së Kosovës”, projekt i cili përfshin 4 institucione të sigurisë në Kosovë; Ministrinë e FSK, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Korrektues dhe Doganën e Kosovës. Kolonele Cenolli si dhe majore Remzije Zeqiri, oficerë e Departamentit për Marrëdhënie me Publikun në Ministrinë e FSK-së, dhanë një panoramë përmbljedhëse për qëllimin e realizimit të këtij projekti të përbashkët, i cili krahas promovimit të këtyre institucioneve në fushën e sigurisë gjinore, synon dhe motivimin e femrave në zgjedhjen e një profesioni nën uniformë.

Në fund të takimit, u rikonfirmua edhe njëherë dëshira e mirë dhe vullneti i përbashkët për vazhdimin e aktiviteteve të tilla si dhe zgjerimi i kontributeve të përbashkëta e rajonale në promovimin e figurës së femrave nën uniformë.

Arsino Demiri, shpallet nënoficeri më i mirë i vitit në Forcat e Armatosura

Përzgjidhet nënoficeri i vitit 2014 në Forcat e Armatosura

Tashmë është kthyer në traditë përzgjedhja e nënoficerit më të mirë të vitit në Forcat tona të Armatosura. Për këtë qëllim, në sheshin qendror të garnizonit "Skënderbej" u zhvillua një ceremoni e veçantë. Morën pjesë: shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, komandantët e Forcave, drejtorë dhe ushtarakë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, komandantë të njësive mbështetëse, si dhe efektive nga trupa e nënoficerëve.

Për të ardhur deri këtu, për të dytin vit radhazi, me iniciativën e trupës së nënoficerëve, mbështetjen e kuadrit drejtues e komandues, bashkëpunimin ndërmjet komandave të njësive dhe asistencën e Zyrës së ODC-s, u zhvillua procesi i përzgjedhjes së nënoficerit më të mirë për vitin 2014 në të gjitha komandat e Forcave dhe të njësive të tjera ushtarake. Finalizimi me sukses i këtij aktiviteti kaloi në një seri fazash përgatitore, ku ndër më kryesoret ishin: përgatitja e urdhrave dhe udhëzimeve për zhvillimin e këtij aktiviteti, hartimin e rubrikave të testimit, përgatitja e testeve dhe standardizimi, ngritja e bordeve të vlerësimit deri në nivel batalioni, përzgjedhja e 3 nënoficerëve më të mirë në nivel Force dhe deri në përzgjedhjen e nënoficerit të vitit në Forcat e Armatosura.

Në përfundim të këtij procesi, 21 nënoficerët më të mirë të përzgjedhur në në Forca dhe në njësitë ushtarake, u ballafaquan në konkurrimin final për t'u përzgjedhur si nënoficeri më i



mirë i vitit në rang Force të Armatosur. Duhet theksuar se një nga të veçantat e këtij viti ishin bordet e vlerësimit, ku përbërja e tyre ishte vetëm nga trupa e nënoficerëve.

Pas përfundimit të testimeve, vlerësimit të aftësive të shfaqura nga konkurrentët u bë renditja në bazë të listë meritës. Rreshtere Arsino Demiri, me detyrë Instruktor Përgjegjës në Akademinë e Nënoficerëve "Thomson" u përzgjodh nënoficeri më mirë i vitit 2014 për Forcat e Armatosura.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, pasi përshëndeti trupën e nënoficerëve për iniciativën e marrë, vuri në dukje progresin e bërë në kualifikimin, ven-

dosjen e kriterëve për avancimin në gradë, si dhe nevojën e transformimit të kësaj trupe në rritjen e standardeve dhe marrjen e përgjegjësisë nga vetë trupa e nënoficerëve për zhvillimin e këtyre standardeve. Më pas, gjeneralmajor Bazo i dorëzoi rreshtere Arsino Demirit çmimin e vendit të parë, me moton "Nënoficeri i Vitit 2014 - Stërvit dhe Udhëhiq", si dhe certifikatën e vlerësimit "Nënoficeri i Vitit 2014 për FARSH" me motivacionin "Për performancë të shkëlqyer në realizimin e detyrave të ngarkuara, rezultate të larta në kualifikime, trajnime e stërvitje dhe kontribut në shërbim të FARSH për vitin 2014".



Në Akademinë e Forcave të Armatosura Akademia e FA, konsultë për rishikimin e programeve mësimore

Një ndër prioritetet e punës së Akademisë së Forcave të Armatosura për vitin akademik 2014-2015 është rishikimi i programeve mësimore që zhvillohen në Akademi. Për këtë, në ambientet e Akademisë së Forcave të Armatosura u zhvillua konsulta me temë: "Përmirësimi i programeve mësimore të Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP) dhe Kursit të Lartë të Oficerit (KLO)". Konsulta u drejtua nga komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, kolonel Idriz Haxhiaj. Në takim morën pjesë stafi pedagogjik i AFA, si dhe ushtarakë që kanë përfunduar studimet në akademitë homologe të vendeve anëtare të NATO-s.

Konsulta u zhvillua në formë bashkëbisedimi. Duke bërë një krahasim me eksperiencat që kanë sjell ish-studentët tanë në akademitë e vendeve perëndimore, si edhe duke marrë parasysh kushtet tona, rezultoi se ka vend për rishikimin e raporteve të moduleve që jepen në këto kurse. Theksi duhet vënë në përgatitjen më të mirë operacionale të studentëve në mënyrë që të jenë të aftë të kryejnë me sukses detyrat gjatë dislokimit në kuadër të operacioneve të NATO-s. Aplikimi i metodave moderne të mësimdhënies dhe mbështetja më e mirë me infrastrukturë mësimore ishin disa nga sugjerimet e diskutantëve gjatë konsultës. Në AFA do të vijojnë të zhvillohen aktivitete të tilla edhe gjatë fillimit të vitit të ardhshëm me synimin e përgatitjes për kurset e këtij lloji që parashikohen të fillojnë gjatë vitit akademik 2015-2016.

Takim pune me përfaqësuesin e Zyrës së ODC për kursin "Black Eagle 002"

Në Akademinë e Forcave të Armatosura, u zhvillua një takim pune me përfaqësuesin e Zyrës së ODC Major Richard Karcher. Në takim morën pjesë komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, kolonel Idriz Haxhiaj, shefat e departamenteve të Fakultetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, si dhe oficerët e rinj që kanë përfunduar studimet në vendet e ndryshme të NATO-s. Objekti i takimit ishte marja e masave paraprake për kursin "Black Eagle 002". Në kursin përgatitor që do të zhvillohet në Akademi do të meret parasysh eksperiencia e programit të mëparshëm të ndjekur me kursantët e "Black Eagle 001", si dhe eksperiencia më e mirë që implementohet në akademitë e vendeve të NATO-s, eksperiencë e dhënë kjo nga ushtarakët që kanë përfunduar studimet në

akademitë homologe të vendeve të NATO-s. Takimi u zhvillua në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit që Ministria e Mbrojtjes ka me SHBA për përgatitjen e oficerit të ri, në bashkëpunim me Gardën Kombëtare të Neë Jersey-it. Marrëveshja është nënshkruar nga ministria e Mbrojtjes, Mimi Kodheli në shtator 2013 për një periudhë 5 vjeçare. Faza fillestare e stërvitjes zhvillohet në Akademinë e Forcave



Në kursin përgatitor që do të zhvillohet në Akademi do të meret parasysh eksperiencia e programit të mëparshëm të ndjekur me kursantët e "Black Eagle 001"

të Armatosura nga Departamenti i Përgatitjes së Oficerit të Ri, ku prezente është edhe asistencë e përfaqësuesve të Gardës Kombëtare të Neë Jersey-it. Në fazën e dytë kandidatët për oficer përgatiten në Gardën Kombëtare të Neë Jersey-it.

Zbatimi i kësaj marrëveshje këtë vit do të jetë në mënyrë intensive. Do të ketë dy grupe mësimore që do të përgatiten në kohë të ndryshme. Faza fillestare e grupit të parë do të fillojë në janar 2015 dhe do të përfundojë në mars 2015. Në muajin prill 2015 do të vijojnë përgatitjet në Shkollën Federale të Kandidatëve për Oficer në SHBA. Ndërsa grupi i dytë do të fillojë stërvitjen në AFA në muajin mars 2015 dhe do të vijojë stërvitjen në Shkollën e Kandidatëve për Oficerë në Neë Jersey në korrik 2015.

Nënkolonele ALDA SULA

Flet Lida Grazhdani, oficerja që i përket brezit të parë të vajzave shqiptare që nisën rrugëtimin në karrierën ushtarake që në vitin 1967

Rruga jonë drejt integrimit në Forcat e Armatosura ishte mbi të gjitha rrugë emancipimi

Përvoja 45 vjeçare e grave në FA, është përvojë që u përket jo vetëm atyre, por edhe historisë të ushtrisë

INTERVISTOI
ETLEVA SMAÇI

Takimi me nënkolonele (R) Lida Grazhdani nuk ishte i lehtë për mua. E njoh pak, vetëm rreth një orë të kaluar me të në promovimin e librit të saj “Pesha dhe bukuria e uniformës”. Ajo i përket brezit të parë të vajzave shqiptare që nisën shkollimin ushtarake në vitin 1967. Më është dashur të ulem dhe ta lexoj këtë libër, jo thjesht për të kuptuar rrugëtimin e vështirë, por jo të pamundur të femrës shqiptare për t’u integruar në Forcat e Armatosura, por së pari për të kuptuar vlerën e tij dokumentare. Sepse të tillë e konsideroj këtë libër, një dëshmi autentike dhe unike, ku me të drejtë autorja i lejon vetes të gërshetojë llojet e shkrimit (nga ai akademik në rrëfime narrative me nuanca prozaike, e deri tek elementi biografik). Por pyetjet e mia nuk mund të marrin përgjigje brenda një nate leximi. Madje mëngjesi i takimit më gjen pak më të “hutuar” mbi të panjohurat që libri më shfaq. Kështu që më duhet të pres jo pa emocion ardhjen e Lidës. Një ardhje që e di se do të jetë edhe takim me një ushtarake karriere, edhe me një shkrimtare, por edhe me një grua, çka më bën të ndihem mirë, të ndihem e përfaqësuar. Po kush është Lida Grazhdani? Lida e nis rrëfimin e saj me Korçën, qytetin ku ka lindur dhe ka kaluar vitet e paharruara të fëmijërisë, pastaj me Tiranën, me Elbasanin ku ka filluar për herë të parë të shkruajë e të botojë, me Sarandën ku mbaroi shkollën e mesme të përgjithshme “Hasan Tahsini”. Në këtë rrugëtim një vend të veçantë zënë dy prindërit e saj, njerëzit që e frymëzuan dhe i shërbyen si model i karrierës së ardhshme. Të dy ata vinin nga radhët e mijëra të rinjve që luftuan për çlirimin e vendit dhe ndërtimin e tij. E pikërisht në këtë vatër atdhedashurie mori krahë dhe vendimi i saj për të ndjekur shkollën ushtarake, për t’u bërë oficerë, një profesion që edhe për burrat ishte i vështirë.

Znj. Lida, në moshën 17 vjeçare ju morët një vendim shumë të rëndë-



Nënkolonele (R) Lida Grazhdani

sishëm për jetën tuaj. Edhe pse ishit një maturante me mesatare të lartë, që kishit fituar të drejtën për të studiuar në Univesitetin e Tiranës në degën Anglisht, ju iu përgjigjët kërkesës për të ndjekur shkollimin ushtarak, një profil që deri në vitin 1967 nuk ekzistonte për femrat në vendin tonë. Pra, nuk kishte një model të gruas ushtarake profesioniste që mund t’ju frymëzonte. Ishte një terren i panjohur? Çfarë ju shtyu ju personalisht në këtë rrugë?

Lida Grazhdani: Mendoj se ajo që më bëri të zgjedh midis shumë mundësive të tjera, pikërisht karrierën ushtarake, të panjohur, të pashkelur në plotshmërinë e vet nga femrat, një profesion tradicionalisht burrëror dhe të vështirë, nuk është një arsye e vetme dhe nuk mund të kuptohet pa njohur, pa pasur parasysh shoqërinë shqiptare të viteve ’60-të. Ato vite kanë pasur si karakteristikë kryesore një lëvizje të fuqishme të elementeve të ndryshëm të shoqërisë shqiptare të nxitur, gjallëruar e drejtuar me pikësnyime të qarta e të programuara nga partia shtet. Gjithë jeta e vendit lëvizte nën parullën: “Të

ndërtojmë socializmin duke mbajtur në një dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën”. Njëkohësisht zhvillohej një lëvizje e madhe për emancipimin e gruas. Gruaja cilësohej si një forcë e madhe për ndërtimin dhe mbrojtjen e Atdheut. Në këtë atmosferë politiko-shoqërore u iniciua edhe hyrja e femrave në shkollën ushtarake. Pra, ajo që quhej fryma e kohës ishte e mbushur me entuziazmin e përpjekjeve, sakrificave

“

Ne nisëm një rrugë të vështirë dhe e çuam deri në fund. Ne çelëm një rrugë të re për gruan shqiptare, që u ndoq nga qindra të tjera dhe mbeti një rrugë e hapur suksesi

dhe angazhimeve në emër të përparimit të vendit dhe mbrojtjes së tij. Gjithkush duhej të bëhej pjesë e kësaj përpjekjeje që lidhej me nocionin madhor: Atdhe. Pra, dëshira dhe bindja për të bërë atë që ishte në interes të vendit ishte shtysa më e madhe drejt rrugës që zgjodhëm unë dhe shoqet e mia. Ne ishim brezi i pasluftës që në edukimin e vet kishte respektin e madh për ata që çliruan vendin nga pushtuesit dhe figura kolektive e mijëra vajzave pjesëmarrëse në këtë luftë e bënte figurën e ushtarakut të nderuar. Unë, ashtu si dhe shumë shoqet e mia, sigurisht që kisha pasur dëshirën për të studiuar në universitet dhe e fituam atë të drejtë, por hyrjen në shkollën ushtarake e pritëm me optimizmin e kohës dhe të moshës që kishim.



Sa e njihnit ju jetën ushtarake në moshën 17 vjeçare? Dhe sa e përgatitur ishit për fillimin e kësaj jete, që më pas do t’ju kthehej në profesion?

Unë personalisht nuk e njihja jetën ushtarake. Isha edukuar me respektin për njerëzit që i shërbenin mbrojtjes së vendit dhe dija shumë pak gjëra nga kjo fushë, aq sa na kishte dhënë programi i shkurtër që bëme në dy vitet e fundit të gjimnazit. Por rrugës së panjohur të këtij profesioni i hymë me kurajo dhe optimizëm.

Në ç’detyra shërbyen përgjithësisht oficeret e kursit të parë të diplomuara në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve. A ishte karriera e tyre e suksesshme sa ajo e shokëve të tyre të kursit?

Kursi i parë i vajzave të diplomuara në shkollën ushtarake përbëhej nga 70 vetë, 27 në specialitetin e këmbësorisë, 23 në ndërlidhje dhe 20 në specialitetin e financës. Emërimet në detyra respektuan shkollimin dhe u dhanë mundësinë





të shërbenin në shumë sektorë të punës në ushtri. Duke gjykuar mbi kontributin e tyre nisur nga vitet e punës në sektorë të ndryshëm, është fakt që më shumë vite pune ky grup dha në sektorët e mëposhtëm: financë, ndërlidhje, stërvitjen e rinisë shkollore e studentore, në administratë, mësimdhënie në shkollat ushtarake, në degët ushtarake dhe organizim mobilizim, por edhe në

detyra komanduese etj. Karriera e tyre ishte një karrierë e plotë, pasi 43 prej tyre shërbyen në ushtri për 21-25 vjet, 13 shërbyen 25-30 vjet dhe 9 të tjera më shumë se 30 vjet. Vetëm 5 vetë nuk plotësuan 12 vjet si oficerë aktive. Me rivendosjen e sistemit të gradave në vitin 1991, 6 arritën gradën Nënkolonel, 13 gradën Major dhe 41 gradën Kapiten i Parë. Bëjnë përjashtim këtu 11 prej tyre që

ishin liruar nga ushtria para rivendosjes së gradave. Duhet thënë se, më pas, një numër i konsiderueshëm i oficerëve të këtij grupi kryen studimet e plota universitare në degë të tilla si financë, gjuhë-letërsi, flozofi, histori-geografi etj. Po qe se do t'u ishte dhënë e drejta e studimit në Akademinë Ushtarake dhe po qe se nuk do t'u qe ndërprerë karriera aktive për shkak të reformës, nga



MIMI KODHELI
Nga parathënie e librit "Pesha dhe bukuria e uniformës"

"Për gratë është gjithnjë e vështirë të pajtojnë jetën familjare, rritjen e fëmijëve me punën dhe ecjen në karrierë, por sa i vështirë është ky pajtim për një grua ushtarake! Këtë Lida e ka përshkruar me hollësi, por pa e vështruar aspak si diçka të pamundur, përkundrazi. Mesazhi i saj se asgjë nuk është e pakalueshme, se edhe mjedisi më tradicional i burrave mund të ndryshohet, është shumë i qartë".

ky grup do të kishte shumë më tepër gra me detyra dhe grada më të larta.

Në këtë "garë" me burrat, çfarë mendoni se keni përcjellë ju si mesazh për femrat që janë tashmë ushtarake apo dëshirojnë të ndjekin këtë rrugë?

Nuk mendoj se duhet ta quajmë "garë" me burrat. Hyrja jonë në shkollën ushtarake ishte një hap kurajoz dhe një përpjekje e suksesshme për integrimin e femrave në një profesion e mjedisi që tradicionalisht u kish takuar burrave. Ne nuk do të mund të integroheshim me sukses pa mbështetjen dhe ndihmën e tyre, por edhe nuk do të qemë kaq të suksesshme pa "kundërshtimin" ose pranimin e ngadalshëm të tyre. Rruga jonë drejt integritit në Forcat e Armatosura ishte mbi të gjitha rrugë emancipimi që kërkonte jo vetëm guxim e kurajo, por edhe durim, këmbëngulje, pikësynim e vullnet. Oficerëve të reja ose vajzave që zgjedhin të ndjekin karrierën ushtarake do t'ju

thoshja se keni bërë një zgjedhje sa të bukur aq edhe fisnike dhe njëherazi do t'ju uroja shumë suksese dhe të mos lodhen kurrë në përpjekjen për të arritur edhe atë sukses që në fillim duket i vështirë ose i pamundur. Në librin "Pesha dhe bukuria e uniformës" unë jam përpjekur ta jap rrugën e gruas ushtarake shqiptare nën uniformë me vërtetësi, mbështetur në fakte, gjykime po edhe në përjetimet emocionale, për ta bërë sa më të prekshme për lexuesit. Nuk mendoj se arrita t'i them të gjitha, jam e gëzuar nëse ky libër do të jetë një gjurmë e lënë në historinë e karrierës së grave ushtarake, që do të pasohet nga libra të tjerë.

Znj. Lida në jetën e çdo individi ka "pengje" profesionale. Ju duket se nuk keni asnjë hezitim për zgjedhjen tuaj profesionale, por koha nuk ishte "aleatja" juaj më e mirë. Nëse do të ishit sot pjesë e FASH, që janë anëtarë të NATO-së, çfarë do të kishte qenë ndryshe?

Profesionalisht mendoj se shumica e grupit të parë të grave ushtarake ishin të suksesshme, ashtu si mund të ishin edhe në shumë profesione të tjera. Ne nisëm një rrugë të vështirë dhe e çuam deri në fund. Asnjëra nga ne nuk ishte protagoniste, por të gjitha së bashku, si grup, po. Ne çelëm një rrugë të re për gruan shqiptare, që u ndoq nga qindra të tjera dhe mbeti një rrugë e hapur suksesi. Pse mendoni se koha nuk ishte aleatja jonë? Çdo brez formohet në kohën e tij dhe e jeton atë. Natyrisht, hapësira që na la koha që jetuam në Forcat e Armatosura kishte kufizimet e veta. Sot gratë ushtarake janë më të motivuara, shkollimi ushtarak u jep shumë më tepër njohuri dhe rrugët e karrierës janë më të hapura, shkëmbimi i përvojave me ushtarakë të vendeve anëtare të NARO-së i jep tjetër dimension pjesëmarrjes në FA. Dhe këtë besoj se e ka arritur brezi i tanishëm i ushtarakeve në karrierë, që janë pjesë aktive e misionëve tona paqeruajtëse, apo ato vajza e gra ushtarake që kryejnë detyra tepër të rëndësishme si përfaqësues ushtarake të vendit tonë, brenda dhe jashtë atdheut. Koha që jetuam ne pati sfidën e integritit të femrës brenda ushtrisë shqiptare, e sotmja mbart sfidën e integritit dhe të qënurit dinjitoze si pjesëtare në aleanca të mëdha si NATO-ja dhe marrja pjesë në operacione reale për mbrojtjen e paqes dhe të sigurisë në botë.

LIDA GRAZHDANI



Pesha dhe bukuria e UNIFORMËS

Tiranë, 2014



MAJOR LULZIM SALIH
N/KOLONEL EDIAND ELEZI

Stërvitja “Taraboshi-14” mbyll siparin e ciklit stërvitor të Forcës Tokësore për 2014

Në Qendrën e Simulimit (QS), nga data 1 deri më 16 dhjetor 2014, u zhvillua stërvitja “Taraboshi-14” me pjesëmarrjen e B 1K të Vaut të Dejës, B 3K të Poshnjës, si dhe me Batalionin Komando të Forcës Tokësore. Planëzimi i stërvitjes u bazua duke aplikuar direktivën e stërvitjes së NATO-s, BI-SC 75-3, Manualin e Ushtrisë Amerikane TC-7 101 “Planëzimi i stërvitjes në Shtab”, ku i gjithë dokumentacioni dhe procedurat u zbatuan përgjatë dinamikës së stërvitjes. Planëzimi i kësaj stërvitje ka filluar qysh në shkurt të këtij viti, bazuar në direktivën e NATO-s BI-SC 75-3, që cikli planëzimit stërvitor të niveleve të tilla të mos jetë më pak se 180 ditë, duke u pasuar me takime dhe konferenca për ndërtimin e strukturës së stërvitjes, hedhjen e të dhënave të terrenit dhe të strukturave pjesëmarrëse në stërvitje në database-in e QS, trajnimin e audiencave stërvitore, por edhe zhvillimin e orëve akademike në interes të realizimit të objektivave të stërvitjes. Në këtë kuadër, QS, nëpërmjet krijimit të ekipeve trajnuese lëvizëse (Mobile Training Team) mundësoi trajnimin e shtabeve të batalioneve të këmbësorisë në Vaun e Dejës dhe Poshnjë për Procesin e Vendimmarrjes Ushtarake, Procedurat e Drejtimit të Trupave, modele mbi ndërtimin e Qendrave Operacionale Taktike etj, duke konkluduar që për planëzimin e kësaj stërvitje janë harxhuar me qindra orë teorike, akademike dhe praktike.

Disa nga objektivat e stërvitjes “Taraboshi-14”

- Kryerja me cilësi të lartë e Procesit të Vendimmarrjes Ushtarake, organizimi dhe drejtimi i operacionit nga Vendkomanda (CPX/CAX) nga ana e komandantëve, shtabeve dhe personelit të batalioneve pjesëmarrës në stërvitjen “Taraboshi-14” dhe simulimi në QS për t’i mundësuar personelit pjesëmarrës të shohin rezultatet/pasojat e planifikimit dhe vendimmarrjes së tyre.
- Aplikimi i mësimave të nxjerra më parë për planëzimin, zhvillimin dhe vlerësimin e stërvitjes, maksimalizimin e vlerave trajnuese të kësaj stërvitjeve për drejtuesit e batalioneve.
- Ndërtimi i bazës së njohurive kolektive që kanë lidhje me efikasitetin/ menaxhimin trajnues të komandanteve dhe shtabeve të reparteve të FT-së. Të identifikohen në mënyrë sistematike mësimet e vëzhguara/nxjerra dhe praktikant më të mira dhe të aplikohen ato në trajnimet e ardhshme.
- Mbi bazën e objektivave të stërvitjes, shefi shtabit i Forcës Tokësore, si oficeri q kryen stërvitjen, ka hartuar objektivat e trajnimit për audiencën parësore stërvitore (shtabet e batalioneve). Për batalionet 1 dhe 3 mund të përmendim:
- Zbatimi i procesit të vendimmarrjes ushtarake,
- përgatitja zbuluese e fushe luftimit (IPB),
- kryerja e operacioneve me zjarr dhe manovër,
- planëzimi dhe zhvillimi i operacionit mbrojtës,
- planëzimi i mbështetjes logjistike të operacionit,
- planëzimi dhe zhvillimi i procedurave standarde të komandim-kontrollit etj. Për Batalionin Komando mund të përmendim:
- Zbatimi i procesit të vendimmarrjes ushtarake (MDMP),
- zbatimi i procedurave standarde për operacionet speciale nga shtabet e



batalioneve, zbatimi i kërkesave të planëzimit dhe drejtimit të rrethimit dhe kontrollit të objektit, aplikimi i procesit për përgatitjen zbuluese të fushë betejës (IPB), planëzimi i mbështetjes logjistike të operacionit etj. Të gjitha këto objektiva u përmbushen me sukses. Me Batalionin e I dhe III të K të FT stërvitja “Taraboshi-14” u realizua me temë: “Batalioni në luftim mbrojtës”, ku batalioni veproi si forcë reaguese në përbërje të Brigadës Ndërkombëtare, përkrah trupave aleate të NATO-s, si italiane, gjermane, polake. Vendimin që morën komandantët e batalioneve e aplikuan në programin JCATS. Ndërsa me Batalionin Komando u realizuan operacione speciale dhe konkretisht u realizua kapje objekti të rëndësishëm me impakt strategjik në skenarin e stërvitjes, neutralizim e aktivitetit terrorist dhe dorëzimin e këtij objekti në gjendjen e tij fillestare dhe të padëmtuar autoritetve vendore. Duhet evidentuar fakti se nga data 9 deri 13 dhjetor çdo shtab batalioni para zhvillimit të stërvitjes kreu procesin e vendimmarrjes, ku çdo shef dhe specialist në shtab dha kontributin dhe mendimet e veta për të bërë më të mirën në realizimin e misionit. Procesin e Vendimmarrjes Ushtarake (MDMP) është kryer sipas modelit të NATO-s dhe Ushtrisë Amerikane (US Army). Gjithashtu po gjatë kësaj periudhe zhvilluan trajnim në programin JCATS rreth 31 persona nga Batalioni Komando, si dhe rreth 24 persona në programin VBS2 nga Batalioni i FS. Mbas çdo aktiviteti dhe trajnimit me audiencat pjesëmarrëse janë zhvilluar analizat pas veprimit dhe janë diskutuar problematikat që kane dalë pas çdo aktiviteti. Sipas kolonel (R) Dee Esplin, këshilltar i CUBIC pranë QS, ky proces është tepër i rëndësishëm jo vetëm në anën didaktike të procesit të trajnimit, pasi nxit të mësuarit interaktiv të të gjithë audiencës, por është tepër i rëndësishëm për të kuptuar më mirë se si ishin proceset e përdorura por edhe formati dhe cilësia e outputeve të të gjitha hallkave pjesëmarrëse në stërvitje. Vlen të përmendet angazhimi i çdo personi në diskutim, ku më shumë

i është dhënë sensit “Çfarë duhet të bëjmë më mirë herën tjetër”. Jo vetëm procesi i planëzimit të stërvitjes, por edhe struktura e saj është ndërtuar mbi bazën e direktivës së stërvitjes të NATO-s BI-SC 75-3 dhe konkretisht e ndarë qartazi në funksione dhe struktura të ndryshme si: oficeri q kryen stërvitjen, drejtuesi i stërvitjes, MEL/MIL, shtabi epror, grupi vëzhguesve, forcat opozitare, audiencia parësore e trajnimit, audiencia dytësore e trajnimit, teknika dhe mbështetja logjistike. Për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e suksesshme të stërvitjes vlen të përmendim dhe të evidentohet puna, kontributi dhe pjesëmarrja e ekipit amerikan të CUBIC, i cili ka asistuar që në fillim të ndërtimit dhe funksionimit të QS, duke mos u mjaftuar vetëm me trajnime dhe mbështetje logjistike, por edhe duke marrë pjesë aktive dhe shpesh herë edhe rolin drejtues të stërvitjeve që zhvillohen në këtë Qendër. Stërvitja “Taraboshi-14” ishte një stërvitje me larmishmeri aktiviteti dhe dinamikë intensive në skenarin e saj, ku spikati puna në grup, angazhimi i pjesëmarrësve dhe niveli i bashkëpunimit midis personelit të shtabeve. Nga ana tjetër personeli i QS u përpoq që i gjithë aktiviteti stërvitor i batalioneve të këmbësorisë të ishte larg shablloneve klasike të luftimit klasik dhe i bazuar në procedurat e planëzimit luftarak më të fundit të përdorura në NATO dhe ushtrinë amerikane, duke i dhënë liri të plotë mendimit krijues dhe origjinal të çdo strukture. Ky synim u arrit pasi të dy batalionet e këmbësorisë, pavarësisht se iu dha i njëjti mision, skenar dhe fushëbetje, planëzimin e tyre e kishin origjinal dhe tërësisht të ndryshëm nga njëri-tjetri. Nga ana tjetër të dy batalionet gjatë zhvillimit të stërvitjes u treguan fleksibël dhe adaptues ndaj situatave të shumta dhe ngjarjeve intensive të zhvilluara gjatë stërvitjes. Ndërsa për Batalionin Komando sfidat në stërvitje ishin akoma edhe më të shumta, pasi skenari i stërvitjes ishte bazuar në sfidat më të fundit të luftës kundër terrorizmit, kryesisht kohët e fundit kundër ISIS në Irak në muajin shtator 2014, ku rëndësia e realizimit



me sukses të saj kishte një impakt strategjik edhe për stërvitjen e batalioneve të këmbësorisë.

Qendra e Simulimit, arritje dhe konsolidim i mëtejshëm

Qendra e Simulimit, nën drejtimin e n/ kolonel Arben Cenollit, me një staf te përgatitur dhe me një përvojë 3-vjeçare, ka bërë të mundur që stërvitja të zhvillohet sipas standardeve duke u bazuar në direktivën e stërvitjes së NATO-s dhe manualin e ushtrisë amerikane. Një risi në këtë stërvitje ishte edhe konceptimi i organizimit të strukturave të Forcës Tokësore sipas konceptit të Task Forcës së NATO-s, duke i vendosur batalionet e këmbësorisë nën vartësi të Komandës së Komponentit Tokësor të NATO-s, ndërsa Batalioni Komando në vartësinë e Komandës së Komponentit të Forcave Speciale të NATO-s. Kjo risi solli edhe një sfidë më të madhe për shtabin e Forcës Tokësore, i cili kishte rolin e Komandës së Komponentit Tokësor të NATO-s, por edhe të Komandës së Komponentit të Forcave Speciale të NATO-s, sfidë e cila detyroi shtabin e Forcës Tokësore që në drejtimin e kolonel Ilir Xhepaxhia të ishte sa më fleksibël, adaptiv dhe të kuptonte, ushtronte filozofinë dhe konceptin e drejtimit dhe përdorimit si të forcave konvencionale tokësore ashtu edhe të atyre komando. Nga ana tjetër QS dhe ekipi i CUBIC pranë saj mundësoi vëzhgimin, asistencën dhe vlerësimin e stërvitjes dhe personeli i saj me profesionalizëm kanë ndjekur hap pas hapi shkallën e përvetësimit dhe zbatimit të objektivave të trajnimit dhe të stërvitjes. Ajo që u vlerësua më shumë gjatë zhvillimit të stërvitjes “Taraboshi-14” ishte fakti që në këtë stërvitje çdo pjesëmarrës ka ngritur nivelin e tij profesional dhe kulturën e punës, duke aplikuar praktikën më të mira dhe modelet që kërkon koha në realizimin e misionit. Nga ana tjetër ishte tërësisht e pranuar nga të gjithë që niveli i përgatitjes së shtabeve të batalioneve të këmbësorisë ka njohur rritje nga viti në vit, duke arritur nivele më të larta përgatitje në planëzimin, vendimmarrje dhe fleksibilitet të përdorimit të trupave në terren, duke iu përgjigjur dhe kundërvënë gjithnjë e më shpejtë kundërshtarit. Sipas n/ kolonel Arben Cenollin, shefi i QSt dhe kolonel (r) Dee Esplin,

këshilltar i CUBIC pranë kësaj Qendre, synimet e QS për vitin 2015 janë akoma edhe më ambicioze. Drejtimet kryesore të veprimtarisë së QS për vitin 2015 do të jenë:

- Zhvillimi sipas standardeve të NATO-s dhe me nivel të lartë i stërvitjeve të planifikuara me njësitë e repartet e FA-së dhe institucione të tjera. Synimi kryesor është konsolidimi i të gjitha praktikave dhe përvojës së fituar deri tani në planifikimin dhe zhvillimin e stërvitjeve, duke aplikuar standartet dhe metodologjinë e NATO-s dhe të Ushtrisë Amerikane (US Army). Nga ana tjetër do të synohet rritja e nivelit të zhvillimit të stërvitjeve sipas konceptit “Joint” dhe “Combined”, duke synuar aktivizimin e personelit të Forcës Ajrore, Forcës Detare dhe Forcave Speciale edhe në stërvitjet e njësive dhe reparteve të Forcës Tokësore, apo të kurseve institucionale.

- Konsolidimi i mëtejshëm i QS-së në kuadër dhe si pjesë e programeve të mbrojtjes. Për këtë nëndrejtimet kryesore do të jenë: përgatitja dhe trajnimi i vazhdueshëm i personelit në kurse funksionale për të mbështetur ushtrimin e përgjegjësi dhe kohezionin në veprimtarinë e QS-së; Freskimi i programeve kompjuterike mbi të cilat operojnë programet bazë të simulimit dhe rritja e kapaciteteve teknike të tyre; mirëmbajtja, riparimi dhe zëvendësimi i teknikës e teknologjisë kompjuterike në përdorim në mënyrë të vazhdueshme; hartimi i bazës së nevojshme procedurale dhe konceptuale që sanksionon të gjithë veprimtarinë e QS në kuadër të KDS e më gjërë etj.

- Kontributi i QS për konsolidimin dhe modernizimin metodave të zhvillimit të stërvitjeve në institucionet arsimore të FA-së, bazuar në doktrinat, parimet dhe procedurat e NATO-s. Synimi kryesor në këtë aspekt do të jetë hartimi i një manuali “Blue-Black” (shqip-anglisht) mbi procedurat, taktikat dhe teknikat që komandantët e togave, kompanive dhe shtabet e batalioneve duhet të zotërojnë kur zhvillojnë stërvitje simuluese (CAX/CPX).

- Trajnimi i personelit të QS-së në kurse institucionale dhe trajnimi në kuadër të procesit të edukimit në FA. Planifikimi dhe dërgimi i personelit të QS në kurse të ndryshme funksionale e institucionale që zhvillohen në kuadër të FA në interes të zhvillimit të karrierës individuale do të jetë prioritet dhe do të jepet mbështetja e duhur në këtë drejtim. Pavarësisht nga kjo, një drejtim i punës së QS do të jetë edhe vijimi me intensitet të lartë të “on-job-training” të të gjithë personelit të saj nën drejtimin e përfaqësuesve të CUBIC.

- Vazhdimi i bashkëpunimit me IGJU për hartimin e hartave dhe terreneve specifike dixhitale 3D dhe integrimi i tyre me programin JCATS, në interes të stërvitjeve, që do të zhvillohen që do të zhvillohen në QS-së nga repartet e FA-së për vitin 2015.

ALBERT ZHOLI

Një të diel mes fëmijëve të ushtarakëve në



Janë më se 120 fëmijë ushtarakësh, por edhe të punonjësve civilë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura që për vite me radhë janë bërë pjesë e kësaj qendre edukimi kulturor, por dhe argëtimi



Ediel! Mëngjes i ftohtë dhjetori, ndonëse dielli shkëlqen si një ditë pranvere. Tirana ende nuk është zgjuar, ndoshta pas një pushimi të së shtunës ia kanë lënë vendin një gjumi mëngjesor më të gjatë. Nëpër rrugët e saj shikon shumë pak kalimtarë dhe shumë pak makina. Tek-tuk të bie në sy ndonjë polic, apo kalimtar i rastit, që duken të papërfillshëm në raport me ditët e tjera mëngjesore të kryeqytetit. Por, ndryshe nga Tirana e këtij çasti, një institucion i rëndësishëm i Ministrisë së Mbrojtjes, Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes, Muzeut dhe Shtëpive të Ushtarakëve (QKMBMMSHP), është plot gjallëri. Qysh në orën 08.30, grupe fëmijësh të shoqëruar nga prindërit e tyre futen plot dëshirë në mjediset e këtij institucioni. Janë më se 120 fëmijë ushtarakësh, por edhe të punonjësve civilë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura që për vite me radhë janë bërë pjesë e kësaj Qendre edukimi kulturor, por dhe argëtimi. Ata vijnë këtu çdo të shtunë dhe të diel për tu ushtruar në kurset e muzikës, të aktrimit, të pikturës dhe të sportit të karatesë. Të veshur me xhupa, kapele, shalle shumëngjyrësh, ata të krijojnë imazhin e një mozaiku që të fal një emocion të papërshtatshëm. Këto kurse vazhdojnë përgjatë gjithë vitit dhe i bëjnë këta fëmijë të lumtur dhe të dashuruar me këtë institucion. Të gjithë janë të moshës 6-13 vjeç dhe takohen me njeri-tjetrin sikur të jenë pjesëtarë të një familjeje. Ata e kanë kthyer këtë Qendër në një mjedis të bukur relaksues, edukues, por edhe mësues, në një botë gëzimi, hareje dhe mirëkuptimi.

Tufa-tufa, fëmijët pasi përshëndeten me prindërit e tyre, futen në ambientet e reja të QKMBMMSHP, një godinë krejtësisht e rikostruar këtu në buzë të Lanës, jo shumë larg nga Ministria e Jashtme. Në hyrje i presin me buzëqeshje këngëtarë i mirënjohur Kozma Dushi, dirigjenti Halim Teqja, regjizorja Alma Hoti, piktori Ilir Xhaxhiu etj...Fëmijët zënë vendet nëpër sallat e tyre plot dritë dhe ashtu me pafajësinë që i karakterizon shkëmbejnë bisada të ndryshme që lidhen me shkollën, kurset që zhvillojnë këtu dhe me plot informacione që thith bota e tyre fëmijore.

Këtë të diel, bashkë me këta fëmijë të talentuar, vendosa të shoh nga afër diçka nga puna që bëhet për trajnimin e tyre në këto kurse, të shijoj shpirtin e tyre prej artistësh të vegjël, ëmbëlsinë njerëzore që të falin ata. Dhe kontaktin e parë e marr me trajnerët e tyre, që secili në fushën që mbulon është një emër i njohur për të gjithë ne, por edhe nga vetë fëmijët artistë.

Kozma Dushi, këngëtar, tregon:

Në kursin e muzikës ka rreth 45 fëmijë. Ky kurs vazhdon përgjatë gjithë vitit. Tashmë po përgatitemi për Festën e Vitit të Ri. Këtë radhë nuk do të ketë këngë solo, por do të ketë vetëm këngë korale, recitime, bashkëpunim me Cirkun e Tiranës me numra të ndryshme. Të gjithë këta fëmijë këndojnë bukur. Mes tyre ka dhe solistë që janë të spikatur me zërin dhe interpretimin. Ne po punojmë në grup me dirigjentin Halim Teqja, me pianistin Miron Kotani. Disa prej këtyre fëmijëve

kanë vite që ndjekin kursin e muzikës, të këngës, por edhe të aktrimit. Madje ka nga ata që i ndjekin të tria kurset. Nga kjo qendër kulturore kanë dalë këngëtarë, por dhe recitues që sot po bëjnë emër të mirë. Ky kurs ka vite që vazhdon, mund të themi që nga viti 2008 dhe ka fituar një status të veçantë. Fëmijët vijnë me shumë dëshirë si për pikturë, për muzikë dhe për aktrim. Këtu ata marrin mësim profesional dhe ndihen shumë mirë. Me ta ne kemi bërë disa koncerte në festa të

ndryshme, si për festën e 7-8 Marsit, festën e Shën-Valentinit, të 1 Majit, 1 Qershorit, të 28-29 Nëntorit, shpalljes së Pavarësisë dhe të Çlirimit etj. Pra, me këto koncerte ne gjallërojmë jetën artistike jo vetëm këtu në Qendër, por dhe në FA, sepse shpesh ato i kemi zhvilluar edhe në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes, në garnizonin "Skënderbej dhe në njësitë ushtarake. Fëmijët kanë një botë të veçantë, një botë të bukur, një botë të singertë të mbushur me ëndërra të bukura. Tek ata ka vetëm

çiltërsi, ka vetëm sinqeritet. Këta fëmijë më kujtojnë fëmijërinë time, kur shkoja në Shtëpinë e Pionierit në Berat, por ndryshe nga ne, këta fëmijë sot janë më të përgatitur, këndojnë më bukur, kanë kushte më të mira, kanë informacion më shumë, por kanë edhe më shumë pasion...

Miron Kotani, kompozitor, pianist

Mes këtyre fëmijëve ndihem shumë mirë, pasi janë të dëgjueshëm, janë komunikues, janë të afërueshëm. Por jo vetëm kaq. Ata janë edhe shumë

të zgjuar dhe pasionantë për atë çka mësojnë këtu. E thithin menjëherë çka u japim. Kanë dëshirë për të ecur përpara. Ja, p.sh., sot po mësojmë një këngë të re, enkas për Festën e Vitit të Ri, që e kam krijuar unë. Gëzuar Vitin e Ri titullohet.

Jemi mbledhur miq e shokë
Sot, Vitin e Ri po festojmë,
Të gëzuar zemrat tona,
Njeri-tjetrin po urojmë.

Kjo këngë u thith menjëherë nga ata. E mësuan për disa minuta. Janë disa koncerte që zhvillohen gjatë vitit dhe këngët e reja janë të pranishme në çdo koncert. Pra, festa sapo ka filluar. Ju këtë padyshim që do ta shikoni në sytë e të gjithë këtyre fëmijëve...

Ejona Sako, 8 vjeç, shkolla 9-vjeçare "Lidhja e Prizrenit"

Jam në klasën e dytë. Unë kam dy vjet që po vij këtu. Jam në kursin e pikturës dhe të muzikës. Këtu kam mësuar shumë gjëra që nuk mund t'i mësoja në vend tjetër. Mësuesit tanë këtu janë shumë të dashur, shumë të duruar, shumë të sjellshëm. Më duket se jam në shtëpinë time. Babanë e kam ushtarak dhe ai më ka mësuar si të jem korrekte. Këtu jam njohur me shumë shokë e shoqe të reja dhe ndihem shumë mirë. Vij me shumë dëshirë dhe mezi e pres të shtunën dhe të dielën. Dëshiroj të bëhem muzikante ose piktores.

Esar Stafa, shkolla 9-vjeçare "Servete Maçi"

Jam në klasën e katërt. Kam tre vjet që vij këtu në të tre kurset: pikturë, aktrim dhe muzikë. Çdo vit mësoj këngë të reja, bëj piktura të reja dhe mësoj diçka më shumë në aktrim. I dua të tria këto lëndë që mësojmë këtu. Kam njohur shumë shokë e shoqe. Deri sa të mbaroj shkollën 9-vjeçare do të vij vazhdimisht në këto kurse. Këtu na japin edhe dhuratat për Vitin e Ri...

Mes ngjyrave të pikturëve të vegjël

Në një sallë tjetër ka më shumë qetësi, por edhe më shumë punë. Fjalën e kemi për kursin e pikturës. Në ambientin ku ata mësojnë shikon me dhjetëra kavaleta pikturë. Të gjithë fëmijët janë të pajisur me kavaleta ku varin në to kartonët, apo telajot për të pikturuar. Në një stendë të madhe janë ekspozuar mbi 30 piktura në karton të fëmijëve. Aty gjen peizazhe, portrete, kompozime dhe natyra të qeta, pra gjen të gjitha gjinitë e pikturave. Në këtë kurs janë 43 fëmijë të moshës 6-13 vjeç ku të gjithë kanë ide, kërkesa, imagjinatë të ndryshme për këtë art të vështirë dhe të bukur. Pikturat e tyre i ngjajnë një mozaiku me lule ku befasohesh nga larmia e ngjyrave. Kanë hapur disa ekspozita me punimet e tyre dhe përgatiten për të hapin të tjera gjatë vitit që vjen....

Kur largohen...

Mirupafshim, mirupafshim, dëgjohen zërat e tyre të bukur teksa ndahen nga mësuesit e tyre. Kapen dorë për dorë me njëri-tjetrin dhe çuqurisën këngën e re. Ashtu të gëzuar vrapojnë tek prindërit duke u përcjellë gëzimet e ditës. Duken si krijuesit më hyjnor të Zotit. Ambienti përreth QKMBMMSHP gumëzhin sërish. Ora shënon 12.00. Tirana është zgjuar, është gjallëruar. Por ky oborr i vogël ende më duket më i bukur, më ngjyreshmumti se çdo ambient i Tiranës në këto momente. Fëmijët largohen duke uruar njeri-tjetrin në pritje të së shtunës dhe së dieles së ardhme, ku sërishmi do të mbushin me zërat e tyre magjik ambientet e QKMBMMSHP.

Ringritja e Flotës Luftarake Detare pas çlirimit të Shqipërisë

Në kuadër të 89-vjetorit të krijimit të Flotës Ushtarake Detare Shqiptare


Nga Kapiten i Rangut të Parë
(R) ARTUR MEÇOLLARI,
pedagog në Akademinë e FA

Riorganizimi i Flotës pas çlirimit të vendit

Çlirimi i Shqipërisë më 29 nëntor 1944 e gjeti vendin plotësisht të shkatërruar dhe po ashtu edhe Marinën Luftarake. Më 29 nëntor 1944 Shqipëria e sapoçliruar nuk kishte asnjë mjet lundrues për të garantuar sigurinë minimale nga deti. Në shkurt 1945, kur kapiteni i parë Abdi Mati u titullua oficer marine i Ushtrisë Shqiptare, detyra e parë që mori ishte riorganizimi i Marinës Luftarake. Nga koha e luftës, në portet shqiptare kishin ngelur të mbytura dy motovedeta të Marinës Mbretërore të Klasit ELCO. Ato u nxorën, u riparuan dhe u vunë në gatishmëri. Më 15 gusht 1945, këto motovedeta (me numër bordi MS-10 dhe MS-12), si edhe motovedeta “Mujo Ulqinaku”, u rifutën në shërbim të Seksionit të Marinës, datë e cila shënon riorganizimin e Marinës Luftarake Shqiptare. Gati një vit më pas, më 22 tetor 1946 do të ndodhte Incidenti i Kanalit të Korfuzit. Në këtë incident 45 marinar britanik humbën jetën, 42 të tjerë ngelën të plagosur, si dhe një kryqëzor dhe një destroyer u dëmtuan rëndë nga minat. Pavarësisht se Shqipëria nuk kishte kapacitete, Incidenti i Kanalit të Korfuzit kishte treguar se Shqipëria duhet të fillonte të krijonte flotën e saj ushtarake.

Flota Luftarake Detare gjatë Luftës së Ftohtë

Në vitin 1954 erdhën nga ish-Bashkimi Sovjetik skuadrilja e parë e katrave silurues, të cilat u pasuan në vitin 1957 dhe 1958 me pajisjen e Flotës Luftarake Detare me nëndetëse, dragamina, gjuajtësa kundër nëndetës, anije polumbare dhe një numër anije ndihmuese. Mbas vitit 1957 Flota Luftarake Detare zotëronte kapacitete luftarake të krahasueshme me fqinjët tanë detare. Si e tillë ajo kreu edhe operacione të rëndësishme. Kështu,



në vitet 1957-1958 Flota jonë Luftarake Detare në bashkëpunim me Forcat Detare Greke realizojë një nga operacionet me të vështira, atë të pastrimit të Kanalit të Korfuzit. Minaheqëset shqiptarë dhe ato greke zhvilluan një operacion masiv, i cili përfshiu gjithë pjesën veriore të Kanalit të Korfuzit duke e deklaruar atë të lirë për lundrim. Kanali i Korfuzit nuk kishte qenë i lirë për lundrim për gati 10 vjet qysh nga incidenti i ndodhur në këtë kanal.

Në këto vite Baza e Pashalimanit u shndërrua në një bazë e fuqishme për Traktatin e Varshavës, anëtarë i të cilit ishte edhe Shqipëria. Këtu u vendosën 12 nëndetëse të mesme taktike të klasit “Wiskey 5”, si dhe shumë anije të tjera mbijvëse. Po në këtë periudhë sovjetikët filluan ndërtimin e bazës së raketave me rreze të mesme (1000 km) në Qafën e Ravenës, mbi Pashaliman, planifikuan ndërtimin e një baze ajrore në Fushën e Dukatit (pranë Pashalimanit) dhe të një baze nëndetësesh në Liqenin e Butrintit. Vizita e pazakonshme gati dy-javore e udhëheqësit sovjetik Hurshov në Shqipëri (25 maj-4 qershor 1959), i cili vizitoi edhe Bazën e Pashalimanit dhe Liqenin e Butrintit, ishte pjesë e këtij plani. Por këto plane nuk u realizuan për shkak të prishjes së marrëdhënieve

me BS.

Pas ftohjes dhe më pas prishjes së marrëdhënieve me ish-Bashkimin Sovjetik, si në të gjithë vendin edhe për Flotën Luftarake Detare situata u përkeqësua. Prishja e marrëdhënieve me BS dha pasoja politike dhe ekonomike, por mbi të gjitha krijoi një tension, sidomos në Bazën Detare të Pashalimanit. Ngjarjet e vitit 1960-61 në këtë bazë ishin treguesi më i dukshëm i tensionit midis dy vendeve. Oficerët, nënoficerët dhe detarët e Flotës Luftarake Detare treguan një heroizëm të jashtëzakonshëm, që më mirë se Ismail Kadare askush tjetër nuk mund ta pasqyronte në romani e tij “Dimri i Vetmisë së Madhe” dhe Piro Milkani dhe Kujtim Çashku në filmin “Ballë për ballë”. Simbolika e Nëndetësës 105 është heroizmi dhe patriotizimi i treguar nga efektivat e Flotës Luftarake në këtë konflikt.

Vitet 1957-1961 kanë qenë vite të vështira për drejtimin e Flotës Luftarake Detare. Nga viti 1945 deri në vitin 1957 komandant i Seksionit të Marinës ka qenë Kapiten i Rangut të Parë Abdi Mati, një oficer detar me përvojë dhe i arsimuar në Akademinë Detare të Livornos, Itali. Mbas vitit 1957 në krye të Flotës u vendos një oficer artiler

me profil politik, gjeneralmajor Teme Seiko, i cili në mes të vitit 1960, regjimi i atëhershëm komunist e shpalli tradhëtar dhe u pushkatua. Në këtë periudhë barra e Flotës i ra Abdi Matit, i cili ishte graduar kundëradmiral dhe për disa muaj u emërua nga zëvendëskomandant i Flotës, komandant i Brigadës së Nën-detëseve dhe komandant i Flotës. Por në gusht të vitit 1960 në krye të Flotës u emërua sërish një ushtarak jo detar me profil politik, Hito Çako, i cili qëndroi deri në vitin 1961 dhe që më pas, në vitin 1974, edhe ai do të ekzekutohej si tradhtar nga regjimi i kohës.

Viti 1961 shënon vitin kur Flota Luftarake u kthye në identitetin e saj profesional. Komandant i Flotës u rimërua për herë të tretë kundëradmirali Abdi Mati, post që do ta mbante për 12 vjet, deri në vitin 1973. Gjatë kësaj periudhe Flota Luftarake u përgatit dhe niveli profesional pati një hop cilësor për përdorimin e teknikës tashmë moderne. Deri nga mesi i viteve ’70-të Flota do të pajisej përsëri me mjete detare tashmë të ardhura nga Kina. Fuqia luftarake e saj kishte arritur në nivele më të larta, po kështu dhe profesionalizmi i personelit të saj. Akademia e Marinës e hapur në Shqipëri në vitin 1961 përgatiti brezat e parë të oficerëve që më pas morën drejtimin e Flotës.

Pas daljes në lirim të kundëradmiral Matit drejtimin e Flotës Luftarake Detare e mori një brez oficerësh dhe komandantësh, të cilët do të ruanin me besnikëri trashëgiminë që ai kishte lënë. Komandantët e ardhshëm të Flotës Qamil Poda dhe Ndue Jaku, do të drejtonin Flotën me profesionalizëm dhe përgjegjshmëri sa edhe kundëradmiral Mati. Po kështu në memorien historike të Flotës janë gdhendur oficerë drejtues të shquar si, Aleko Pojani, Petrit Myftiu, Tasim Meçe, Zisi Anastasi, Muharrem Kuçana, Beqir Gërbi, Shefqet Pinari etj., si dhe një brez i tërë oficerësh të edukuar në Akademinë e Detarisë në Vlorë, si Fitim Halili, Çapajev Smotkthina, Robert Bali, Piro Kuçi, Vladimit Beja, Çapajev File, Ylli Lika, Nikola Tole, Bilbil Aliaj, Kudret



Disa nga anijet e Flotës
Luftarake Detare: Nën-
detëse, Gjuajtësi i Madhë
Detar, Dragamina e Bazës
dhe Katri Silurues

Çela, Petrit Baduni, Mithat Islami, Bashkim Kryeziu, etj.

Fundi i viteve 60-të dhe fillimi i viteve 70-të shënojnë përmirësimin e ndjeshëm të sistemit logjistik të Flotës Luftarake. Në këtë periudhë u punua për shtrirjen e strukturave të Flotës përgjatë gjithë bregdetit të Shqipërisë. Pavarësisht autonomisë së mjaftueshme që kishin anijet, u ndërtuan bazat detare në Kepin e Palit (Bisht-Pallë), në Shëngjin, Sarandë dhe më vonë në Palermo. Në këtë periudhë në strukturën e Flotës u krijua Baza Ushtarake Detare si njësi taktiko-operative, ndërsa sistemi dhe mbështetja logjistike pati përmirësime të ndjeshme. Gjithashtu në këtë periudhë u krijua edhe Kantieri Detar i Pashalimanit, i cili ishte në gjendje të riparonte të gjitha anijet e Flotës.

Fillimi i firmosjes në Montego Bay të Xhamajkës të Konventës së OKB-së mbi të Drejtën e Detit në 10 dhjetor 1982, krijoi një situatë tjetër konfliktuale midis Shqipërisë dhe të drejtës ndërkombëtare. Shqipëria pavarësisht se kishte qenë pjesë e negociimit të Konventës për 13 vjet nuk e firmosi atë. Gjatë periudhës së negociimit, Shqipëria kishte shpallur gjerësinë e detit territorial 15 milje detare, në kundërshtim me këtë Konventë. Në janar 1983 Flota Luftarake Detare, kur komandant



Komandantët e Flotës
Luftarake Detare gjatë
Luftës së Ftohtë.
Kundëradmiral Abdi Mati
(1945 – 1957, korrik-dh-
jetor 1961, 1961-1973,
Gjeneral Brigade Teme
Sejko (1957-1960),
Gjeneral Brigade Hito
Çako (1960-1961), Qamil
Poda (1973-1981), Ndue
Jaku (1981-1990).



ishite Ndue Jaku, i propozoi qeverisë së Shqipërisë ndryshimet e nevojshme në legjislacionin e kufirit detar dhe përputhjen me konventën, por ky propozim nuk u mor në konsideratë. Në shtatë vitet e ardhshme Shqipëria do të hynte në një kundërshti diplomatike me SHBA dhe Flota Luftarake Detare të angazhohet kundër operacioneve deklaruese të Forcave Detare të SHBA. Midis viteve 1984-1989 anijet ushtarake të SHBA hynin në ujërat territoriale të Shqipërisë për të demonstruar palgjëshmërinë e gjerësisë së tyre prej 15 milje detare. Por kjo do të ishte edhe e fundit e kësaj periudhe, pasi në fund të viteve 90-të gjërat do të ndryshonin, ligji për kufirin detar do të ndryshonte dhe SHBA do të bëhesh aleati dhe partneri ynë strategjik më i fuqishëm.

Flota Detare pas vitit 1990

Mbas vitit 1990 Shqipëria pësoi ndryshime të rëndësishme pozitive politike, ndryshime që u pasqyruan edhe në Flotën Luftarake Detare, e cila nga një flotë me karakteristika tradicionale mbrojtëse u transformua gradualisht në një instrument të sigurisë kombëtare. Viti 1997 ishte i rëndë për Flotën Shqiptare, ashtu sikurse për

gjithë Shqipërinë dhe forcat tona të Armatosura. Anijet e Flotës Detare pësuan dëmtime shumë serioze, por sidomos infrastruktura në tokë, por më pas personeli i kësaj Force punoi me shumë përkushtim dhe në pak vite flota u ringrit. Kjo falë edhe ndihmës së pakursyer të partnerëve tanë SHBA-së, Italisë, Turqisë etj. Në mjedisin e ri të sigurisë kombëtare të krijuar, Forca Detare në vitin 2002 mori edhe misionin e Rojes Bregdetare. Kjo i dha Forcës Detare një fizionomi të re si instrument i ushtrimit të sovranitetit dhe mbështetjes së interesave kombëtare. Mbas viteve 2007 Forca Detare hyri në një proces modernizimi nëpërmjet ndërtimit të një sistemi të vëzhgimit detar modern, prodhimin e katër anijeve të klasit “Iliria”, ndërtimit dhe funksionimit të QNOD-së dhe mbi të gjitha edukimit të një brezi oficerësh dhe detarësh profesionist, të devotshëm dhe përkushtuar. Mjedis i pritshëm i sigurisë kombëtare, por edhe ai rajonal detar kërkon një vizion të ri për Forcat tona Detare: projektimin e kapaciteteve të mjaftueshme për të përballur kërcënimet e së ardhmes ndaj interesave kombëtare detare në zgjerim.



Libri “Incidenti i Kanalit të Korfuzit: Drejtësi e anuar” dhe fotografite e H.M.

Kundëradmiral Abdi Mati, strategu ushtarak që projektoi fuqinë detare të Shqipërisë

Emri i Abdi Matit është i lidhur me zhvillimet më të vrullshme jo vetëm të riorganizimit, por edhe të modernizimit të Flotës Luftarake Detare të Shqipërisë. Ai do ta shoqëronte Flotën Luftarake Shqiptare nga 15 gushti i vitit 1945 deri në vitin 1975, periudhë gjatë së cilës në pjesën më të madhe ka mbajtur detyrën e komandantit të saj.

Abdi Mati u lind më 23 dhjetor 1919 në Fullqet të Matit. Shkollën e mesme e kreu në Kolegjin Ushtarak të Romës (1936-1939). Në vitin 1942 u diplomua në Akademinë Mbretërore Detare të Livornos, Itali. Si oficer i Marinës Mbretërore, Abdi Mati shërbeu në anijen “Amerigo Vespucci”, si dhe më pas në kryqëzorin “Cadorna”. Në shkurt të vitit 1943 lejtant Abdi Mati largohet nga shërbimi në Marinën Mbretërore Italiane dhe kthehet në Shqipëri. Në qershor 1943 doli partizan, fillimisht në çetën e Pezës dhe më pas në detyrë të rëndësishme si, komandant i Batalionit të Tretë të Brigadës së Tretë Partizane të UNÇL dhe në seksionin operativ të Korpmatës së Parë.

Mbas çlirimit, Abdi Mati ishte nga të paktët oficerë marine në Shqipëri. Riorganizimi i shërbimit të marinës ka qenë natyrisht një nga misionet më të vështira të tij. Ai u titullua oficer i marinës shqiptare në shkurt 1945 me gradën kapiten i parë dhe më 8 korrik 1959 Abdi Mati u gradua kundëradmiral.

Kundëradmiral Abdi Mati është strategu ushtarak i cili projektoj fuqinë



Kundëradmiral Abdi Mati

detare të Shqipërisë. Ai në shkurt të vitit 1945, kur u titullua oficeri me i lartë i Marinës, nuk kishte në dispozicion asnjë mjet lundrues. Në 30 vite që shërbeu në Flotën Luftarake kundëradmiral Mati për 25 vjet ishte komandant i saj. Kur ai doli në pension në vitin 1975, Flota Luftarake kishte mbi 100 anije, ndër të cilat katër nëndetëse, 10 gjatësia detarë, mbi 40 karta silurues, tetë minahqëse, polumbare dhe në numër anijesh ndihmuese. Flota Luftarake Shqiptare në këtë periudhë edhe pse operonte e izoluar, nuk ishte e neglizhueshme nga fqinjët tanë detarë, por përkundrazi e krahasueshme. Ai ka lënë një trashëgimi shumë të pasur. Me emrin e Kundëradmiral Abdi Mati janë të lidhura shumë ngjarje të rëndësishme në historinë e Flotës Shqiptare. Ai është riorganizuesi i Marinës Shq-

iptare, bashkëdrejtuesi i operacionit të përbashkët për çminimin e Kanalit të Korfuzit në vitin 1957-1958, vizionari i flotës moderne shqiptare që nisi të ngrihej mbas vitit 1954, krijuesi i Akademisë së Detarisë, komandanti por edhe modeli i oficerit detar, por mbi të gjitha ai ishte strategu që projektij fuqinë detare të Shqipërisë. Tek kundëradmiral Abdi Mati ishin të ndërthurura personaliteti i një ushtaraku profesionist dhe të dedikuar, drejtuesi vizionar dhe me autoritet, njeriut të dashur dhe patriot, por edhe një prindi të përkushtuar. Kundëradmiral Abdi Mati mbetet pa diskutim ushtaraku dhe detari model për çdo oficerë, nënoficer dhe detar të Forcës Detare. Ai është vetë trashëgimia që vazhdon të frymëzoj ende personelin Forcës Detare.

Spiro Kote, detari që nuk shkeli betimin ushtarak...

Më 1 qershor 1947, motovedeta e Marinës Shqiptare “Mujo Ulqinaku” u rrëmbye nga kapteri Vlash Bushi dhe marinarët Xhemal Kërniqi dhe Enver Kruçi. Në anije atë ditë gjendej me shërbim detari Spiro Kote, të cilin rrëmbyesit e gënjyen dhe e morën me vete. Detari Spiro Kote, me trimërinë dhe besnikërinë e tij ndaj betimit ushtarak, bëri të mundur kthimin e Motovedetës “Mujo Ulqinaku” përsëri në Durrës, duke eliminuar tre rrëmbyesit. Ky përfaqëson një akt heroik të “Heroit të Popullit” Spiro Kote dhe që lidhet drejtëpërsëdrejti me gjyqin që po zhvillohej në atë kohë në Hagë për Incidentin e Kanalit të Korfuzit të ndodhur më 22 tetor 1946.

Të kuptosh çfarë ndodhi më 1 qershor 1947, duhet të njohësh Incidentin e Kanalit të Korfuzit, si dhe kthesën që do të merrte gjyqi, nëse nuk do të kishte ndodhur akti heroik i Spiro Kotes. Britanikët nuk arritën të provonin në Gjyqin e Hagës që Shqipëria kishte vendosur minat dhe as që Jugosllavia i kishte vendosur me kërkesën e Shqipërisë. Sipas versionit zyrtar, tre personat që rrëmbyen motovedetën “Mujo Ulqinaku” do të dëshmonin në gjyq se minat ishin vendosur me kërkesë të qeverisë së Shqipërisë. Dështimi i rrëmbimit të motovedetës “Mujo Ulqinaku” dhe rrjedhimisht e dështisë së marinarëve shqiptarë i detyroi britanikët të shikojnë të njëjtën mundësi në Jugosllavi. Po atë vit, në tetor 1947, nga Jugosllavia “me vullnetin e tyre” janë arratisur dy oficerë jugosllavë, një i marinës luftarake, Karel Kovačić dhe një i marinës tregetare, Zhivan Pavlov, të cilët dëshmuuan në Gjyqin e Hagës në favor të akuzës britanike, se



Heroi i Popullit Spiro Kote

minat i kishte vendosur Jugosllavia me kërkesën e Shqipërisë. Dëshmitë e tyre nuk u provuan në procesin gjyqësor.

Sot, mbas 65 vitesh, ka shumë prova që fajësojnë Britaninë e Madhe për Incidentin e Kanalit të Korfuzit, ashtu sikurse mund të pranohet që minat i vendosën jugosllavët me kërkesën e qeverisë së Shqipërisë. Por, tashmë fakti që minat janë vendosur nga Shqipëria nuk provon fajin, pasi shpërthimi i tyre ka ndodhur në detin e brendshëm të Shqipërisë. Kalimi i anijeve britanike është bërë me miratim të kryeministrit britanik Attlee duke dhunuar sovranitetin e Shqipërisë. Pavarësisht se britanikët asnjëherë nuk kanë mohuar përfshirjen e tyre në rrëmbimin e motovedetës “Mujo Ulqinaku, faktet tregojnë se ata kishin arsye për organizonin si të rrëmbimit të motovedetës “Mujo Ulqinaku” edhe të arratisjes së dy oficerëve

dhe historinë e tij deri më 1 qershor 1947, personalisht jam i bindur se atë çfarë beri Spiro Kote nuk e bëri për idealet e komunizmit. Moshë, natyra, eksperiencia politike dhe edukimi i tij e kushtëzonin atë për akte me motive të tilla. Por, nuk duhet të harrojmë se Spirua kishte bërë edhe një betim ushtarak, që natyrisht ai e përmbushi. Spiro Kote nuk u vlerësua vetëm për motivet e aktit të tij. Ai u vlerësua me titullin më të lartë “Hero i Popullit” edhe për atë çfarë parandaloi në rrjedhën e Gjyqit për Incidentin e Kanalit të Korfuzit. Shqipëria e humbi gjyqin dhe u shpall fajtorë, por sot mbas mëse 60 vitesh nën dritën e fakteve të reja, vendimi i Gjykatës së Hagës lidhur me këtë ngjarje është vënë në diskutim. Ky fakt bën që edhe akti heroik i Spiro Kotes merr një dimension të ri, për të cilin shqiptaret kanë arsye të krenohen.



Për më shumë se një dekadë, krah për krah në koalicionin më të madh në histori, për paqen dhe stabilitetin

NATO njeh meritat e misionit ISAF, kapitull i ri në marrëdhëniet me Afganistanin

Këshilli i Atlantikut të Veriut u mbledh për herë të fundit në formatin e Forcës Ndërkombëtare të Ndihmës për Sigurinë (ISAF), më 17 dhjetor 2014. “Për më shumë se një dekadë, kombet tona qëndruan krah për krah në koalicionin më të madh për paqen dhe stabilitetin në histori. Ky ka qenë një mision i vështirë, në shumë aspekte, ushtarakisht, politikisht, ekonomikisht”, tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO Jens Stoltenberg. “Por ne jemi përballur me këto sfida. Së bashku, kemi bërë atë që kemi përcaktuar për të bërë. Me një mandat të qartë të Kombeve të Bashkuara, ne iu kemi mohuar strehën e sigurtë terroristëve ndërkombëtarë. Ne e kemi bërë Afganistanin të fortë dhe vendet tona i kemi bërë më të sigurta”, shtoi zoti Stoltenberg. “Sfidat ende mbeten. Por sot, Afganistani është më i qëndrueshëm dhe më i begatë se kurrë”.

Stoltenberg tha se Aleatët e NATO-s dhe partnerët kishin “besim në aftësinë e Forcave të Sigurisë Kombëtare afgane për të marrë përsipër përgjegjësi të plotë” dhe se një kapitull i ri do të hapet në marrëdhëniet midis NATO-s dhe Afganistanit nga 1 janari i vitit 2015. “Kjo do të përqendrohet në Misionin tonë të ri “Mbështetje e vendosur” për të trajnuar, këshilluar dhe ndihmuar forcat afgane të sigurisë. Ne gjithashtu do të kontribuojmë në financimin e forcave afgane të sigurisë”. Përfaqësuesi i lartë Civil i NATO-s, ambasadori i Afganistanit Maurits Jochems dhe Zëvendës Komandanti aktual i ISAF-it, Gjeneral Lejtnant Carsten Jacobson drejtuan mbledhjen. Ajo u ndoq nga përfaqësuesit e pesëdhjetë e një shteteve të cilat kanë kontribuar në ISAF dhe nga ambasadori afgan në Belgjikë Humayon Tandar.

Në takim morën pjesë Komandanti i ISAF i vitit 2001, kur trupat e ISAF-it u vendosën për herë të parë, Gjenerali Sir John McColl dhe komandanti i misionit në gusht të vitit 2003, gjeneral lejtnant Götz Glimeroth, kur ISAF udhëhoq nga NATO.



“Për më shumë se një dekadë, kombet tona qëndruan krah për krah në koalicionin më të madh për paqen dhe stabilitetin në histori. Ky ka qenë një mision i vështirë, në shumë aspekte, ushtarakisht, politikisht, ekonomikisht”, tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO Jens Stoltenberg.

Rishikimi i Jashtëm shpreh besim të Auditorëve (IBAN), të NATO-s Standarde të larta të transparencës dhe llogaridhënies

Vlerësimi i jashtëm i kolegëve të Bordit Ndërkombëtar të Auditorëve për NATO-n (IBAN) ka gjetur se Bordi i përmbahet standardeve të larta profesionale të efikasitetit dhe efektivitetit. Bordi Ndërkombëtar i Auditorëve është organ



i pavarur i auditimit të Aleancës, me një mandat për të siguruar qeveritë e Këshillit të Atlantikut të Veriut dhe të NATO-s, se të gjitha fondet e përbashkëta janë përdorur si duhet dhe se raportimi financiar është i saktë.

Bordi Ndërkombëtar i Auditorëve për NATO-n, (IBAN), vullnetarisht paraqiti veten për shqyrtim të pavarur në shtator të vitit 2014 në përputhje me qëllimin e tij, për të përmbushur standardet më të larta të transparencës dhe llogaridhënies. Rishikimi i kolegëve ka gjetur se IBAN ka siguruar raporte të auditimit me cilësi të lartë dhe siguri të plotë të qeverive të NATO-s, për fondet e përbashkëta, të cilat janë duke u përdorur në përputhje me udhëzimet e kombeve. Rishikimi është kryer në tetor dhe nëntor të vitit 2014 dhe i është dorëzuar

Këshillit të Atlantikut të Veriut më 16 dhjetor të vitit 2014 nga autoritetet kombëtare të auditimit të Polonisë dhe Spanjës. Ceremonia e parashtrimit të raportit u ndoq nga Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Alexander Vershbow, Përfaqësuesi i Përhershëm polak në NATO Jacek Najder, Përfaqësuesi i Përhershëm i Spanjës në NATO Miguel de Aguirre Cárcer, si dhe Ndihmës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, për Menaxhimin Ekzekutiv Wayne J. Bush. Të gjithë anëtarët IBAN ishin gjithashtu të pranishëm, të udhëhequr nga kryetari Dr. Charilaos Charisis. Delegacioni polak i Gjykatës Supreme të Auditimit kryesohej nga presidenti i saj Krzysztof Kwiatkowski, kurse Delegacioni spanjoll i Gjykatës Supreme të Auditimit udhëhoq nga presidenti i saj Ramón Alvarez de Miranda.

Ukraina sovrane dhe e qëndrueshme kyç për sigurinë Euro-Atlantike

Takim bilateral mes Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s dhe kryeministrit të Ukrainës, Arseniy Yatsenyuk

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg diskutoi përpjekjet e Aleancës për të mbështetur qeverinë e Ukrainës, me kryeministrin ukrainas Arseniy Yatsenyuk në Shtabin e NATO-s, më 15 dhjetor 2014. Sekretari i Përgjithshëm vlerësoi angazhimin e Ukrainës ndaj partneritetit me NATO-n, pavarësisht rrethanave sfiduese, dhe premtoi mbështetje të vazhdueshme politike dhe praktike.

“Vizita juaj, nënvizon partneritetin të fortë midis NATO-s dhe Ukrainës. Ne gjithashtu vlerësojmë shumë që jemi në gjendje të zhvillojmë partneritetin tonë. Dhe veçanërisht për shkak se populli i Ukrainës ka zgjedhur rrugën e demokracisë dhe bashkëpunimin më të ngushtë me Evropën”, tha Stoltenberg. “Ne e mirëpresim atë. Ne theksojmë se vendimi i popullit të Ukrainës duhet të respektohet”.

Sekretari i Përgjithshëm tha se pesë fondet e besimit krijuar nga NATO për të ndihmuar Ukrainën, për të përmirësuar sigurinë e vet tani janë edhe të rrjedhshëm. “Ato kanë për qëllim të bëjnë forcat e mbrojtjes të Ukrainës më moderne, më transparente dhe më efektive”, tha Sekretari i Përgjithshëm. Kontributet e NATO-s përveç mbështetjes dypalëshe, janë ofruar veçmas nga aleatët.

U diskutuan gjithashtu veprimet e vazhdueshme të Rusisë për të destabilizuar Ukrainën. “Z. Kryeministër, ju keni treguar një dëshirë të vërtetë për të gjetur një zgjidhje paqësore të kësaj krize”, tha Sekretari i Përgjithshëm. “NATO mbështet plotësisht Sovranitetin e Ukrainës dhe integritetin territorial”. Thirrja për marrëveshjen në Minsk, është “mënyra më e mirë



JENS STOLTENBERG

“Pesë fondet e besimit krijuar nga NATO për të ndihmuar Ukrainën, për të përmirësuar sigurinë e vet tani janë edhe të rrjedhshëm. “Ato kanë për qëllim të bëjnë forcat e mbrojtjes të Ukrainës më moderne, më transparente dhe më efektive”, tha Sekretari i Përgjithshëm.

për një zgjidhje paqësore”, vlerësoi Stoltenberg përpjekjet e Ukrainës për të zbatuar marrëveshjen dhe i bëri thirrje Rusisë që të bëjë të njëjtën gjë.

Stoltenberg theksoi se një Ukrainë

sovrane dhe e qëndrueshme, e vendosur për demokracinë dhe sundimin e ligjit, është kyçe për sigurinë Euro-Atlantike. “NATO do të qëndrojë me ju, ndërsa ju punoni drejt këtij qëllimi”, tha ai.

Një NATO e fortë siguron stabilitet në Evropë, dhe një Evropë e fortë kontribuon për një NATO të fortë

Stoltenberg: NATO dhe Bashkimi European janë “të fortë së bashku”

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, është takuar para pak ditësh me Presidentin e ri të Këshillit Evropian, Donald Tusk, në selinë e Këshillit në Bruksel. Takimi u zhvillua vetëm pak ditë pas mandatit e ri të Donald Tusk. Stoltenberg theksoi se NATO dhe BE ndajnë së bashku 22 anëtarë, si dhe të njëjtat vlera dhe sfida, në lindje dhe në jug. Të dy udhëheqësit diskutuan mbi destabilizimin e vazhdueshëm të Ukrainës nga Rusia dhe ndikimin e tyre në stabilitetin e Euro-Atlantik. Sekretari i Përgjithshëm tha se “Rusia ka shkelur parimet themelore. Kufijtë nuk mund të ndryshohen me forcë. Mosmarrëveshjet duhet të zgjidhen me anë të bisedimeve, jo me tanke. Epoka e sferave të influencës është e gjatë. Këto parime janë baza e Europës paqësore që ne kemi ndërtuar për dy dekada, së bashku me Rusinë”. Stoltenberg u shpreh se një NATO e fortë siguron stabilitetin në Evropë, dhe një Evropë e fortë gjithashtu kontribuon për një NATO të fortë.



Ai nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm të ngushtë për një mbrojtje më të fortë, dhe përmendi Këshillin European të vitit të ardhshëm si një “hap vendimtar”. Ai bëri thirrje për NATO-n dhe Bashkimin Evropian që të vazhdojnë të punojë në bashkëpunimin reciprok, “kështu që në një botë të rrezikshme, ne mund dhe duhet të jemi më të fortë së bashku”.

Përgatiti faqet: Mimoza Golikja/ Burimi nato.int

Ndihmës Sekretari i përgjithshëm i NATO-s Stamatopoulos takohet me Kryeministrin e Mauritanisë

Ndihmës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, për Çështjet Politike dhe Politikën e Sigurisë, Ambasadori Thrasyvoulos Terry Stamatopoulos, u takua me kryeministrin e Mauritanisë, Jahja Ould Hademine në Nouakchott, më 15 dhjetor 2014 dhe diskutuan për partneritetin midis NATO-s dhe Mauritanisë. Në Nouakchott Ambasadori Stamatopoulos mbajti një fjalim në Konferencën e NATO-Mauritani, në përvjetorin e 20-të të Dialogut Mesdhetar. Konferenca përfshinte si pjesëmarrës, parlamentarë mauritanianë, zyrtarë, qeveritarë të nivelit të lartë, akademikë dhe përfaqësues të medias. Gjatë vizitës së tij në Mauritania ambasadori Stamatopoulos mbajti edhe takime bilaterale me ministrin e Mbrojtjes së Mauritanisë Diallo Mamadou Bathia, ministrin e Punëve të Jashtme dhe ministrin e Çështjeve Ekonomike Sidi Ould Tah. Ai u takua gjithashtu me shefin e Mbrojtjes së Përgjithshme Hanana Ould Sidi Hanana.

NJOFTIM

Për kriteret e përgjithshme për rekrutimin e ushtarëve/ detarëve aktiv:

a). Për t'u rekrutuar në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë si ushtar/detar aktiv shtetasit shqiptarë duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale;
- Të mos jetë në ndjekje penale;
- Të mos ketë humbur të drejtën e ushtrimit të profesionit ose veprimtarisë në administratën publike me vendim gjykate;
- Të mos jetë në proces gjykim penal nga gjykata;
- Mosha minimale e rekrutimit është 18 vjeç. Në momentin e titullimit ushtar/detar aktiv, nuk duhet të kenë mbushur moshën 27 vjeç. Përgjashtim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen ushtar/detar aktiv, të cilët do të jenë personel mjekësor i Forcave të Armatosura dhe në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç;
- Të ketë kryer arsimin parauniversitar ose të lartë brenda ose jashtë vendit;
- Të ketë kryer kontrollin shëndetësor dhe të jetë vlerësuar i aftë për ushtar/detar aktiv nga Spitali Ushtarak i FA në Komandën Mbështetëse;
- Të ketë kaluar testin fizik, intelektual dhe psikologjik;
- Kandidatët për ushtar/detarë aktiv të kenë gjatësinë trupore mbi 170 cm për meshkujt dhe mbi 165 cm për femrat;
- Kandidatët për ushtar aktiv të planifikuar për kompletimin e Policisë Ushtarake duhet të kenë gjatësinë trupore mbi 170 cm për meshkuj dhe femra.

b). Për rekrutimin sipas specialiteteve të veçanta, veç këtyre kriterëve të aplikohen edhe kriteret specifike për aftësitë profesionale dhe parametrat fizikë, të cilat përcaktohen me një udhëzim të veçantë të SHSHP.

Procedura e aplikimit për ushtar/detar aktiv:

a) Shtetasit që dëshirojnë të shërbejnë në Forcat e Armatosura si ushtar/detarë aktiv do të aplikojnë drejtpërdrejtë në zyrën e pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit.

b) Aplikantët plotësojnë formularin e aplikimit dhe pranimit të dokumentacionit (bashkëlidhur këtij udhëzimi) dhe marrin njoftimin për dokumentet e nevojshme, afatin e paraqitjes në Qendrën e Personel Rekrutimit për vijimin e procesit të pranimit,

testimit e përzgjedhjes.

c) Procedurat, kriteret, rregullat e testimit bëhen publike në faqen e internetit të Forcave të Armatosura.

Regjistrimi i kandidatëve, dokumentacioni i nevojshëm:

a) Kandidatët për ushtar/detar aktiv paraqesin në Qendrën e Personel Rekrutimit dokumentet e mëposhtme:

- Kërkesë me shkrim, në të cilën parashtrohet identiteti i aplikantit, statusi familjar (martuar, beqar), arsyet për të cilat dëshiron të bëhet ushtar/detar aktiv, njësia apo reparti në të cilin do të dëshiron të shërbyer. Aftësitë, përvoja në punë, prirjet e tij në fusha të caktuara, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi (formulari i aplikimit);
- Fotokopjen e kartës së identitetit;
- Certifikatë familjare;
- Dy fotografi të përmasave 4 x 6cm dhe dy fotografi të përmasave 9x12 cm;
- Fotokopje të diplomës së arsimit parauniversitar ose të arsimit të lartë të noterizuar dhe të vërtetuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale/Rrethit;
- Diplomë, dëshmi, certifikatë për aftësitë profesionale (nëse ka), të noterizuar;
- Dëshmi penaltetit;
- Vërtetim nga prokuroria;
- Vërtetim nga gjykata;
- Fletë të ekzaminimit mjekësor nga Spitali Ushtarak i FA në Komandën Mbështetëse.

b) Periudha e regjistrimit: 1 dhjetor 2014 deri më 14 janar 2015.

Adresa:

Qendra e Personel Rekrutimit, Rruga e “Dibrës”

(Ish-Shkolla e Bashkuar), Tiranë.

Kontakt:

++ 355 69 88 01 195

Ditë emocionesh në përcjelljen e trupave komando në Afganistan

Jemi nisur për në Rinas, në Komandën e Forcave Ajrore, për të marrë pjesë në ceremoninë e përcjelljes së trupave komando për mision në Kabul, Afganistan. Shiu i imët nuk e prish këtë ditë, pasi dukej si një shi ylberi në ditën e bukur të përcjelljes. Ambienti para sheshit të Komandës gumëzhin si rrallë herë. Shikon aty ushtarakë dhe civilë që takohen, përqafohen. Ushtarakët komando trupbukur e plot dinamizëm bisedojnë me njeri-tjetrin. Pranë të tyre janë prindërit, bashkëshortet, fëmijët, motrat, vëllezërit e tyre. Vjen dhe ministria e Mbrojtjes Kodheli, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Bazo, të cilët i takojnë dhe flasin me dashuri, u japin porosi, por edhe mbështetje për detyrat që do të kryejnë në këtë mision të vështirë...Një moment mjaft emocional është dorëzimi nga ministria Kodheli i Flamurit Kombëtar komandantit të kontingjentit, kapiten Melsi Hysa. Flamuri ynë i bukur, me shqiponjën dykrenore do të niset për në Kabul. Më pas, një foto e përbashkët me znj. Kodheli dhe gjeneral Bazon...



• Flasin për gazetën komando dhe familjarë të tyre

KAPITEN MELSI HYSA, KOMANDANTI I KONTINGJENTIT:

Ne kemi marrë pjesë në shumë misione paqeruajtëse, por ky mision është më i veçantë, më selektiv. Për detyrën që ka, përbën risi që ne duhet ta çojmë deri në fund. Janë disa elementë të veçantë të këtij misioni që përcaktojnë rëndësinë e tij dhe që ka bërë që të stërvitemi seriozisht. Unë si komandant i këtij efektiv është hera e parë që marr pjesë në një mision të tillë dhe pse kam 5 vjet që jam pjesë e Batalionit Komando. Kam një emocion që nuk mund ta përshkruaj me fjalë, këtë radhë kam përgjegjësi të dyfishtë edhe si drejtues i misionit, por edhe si pjesë e kësaj trupe. Për të ardhur deri këtu, ne kemi kryer një trajnim specifik për t'iu përshtatur vendit ku do të shkojmë, si dhe detyrave që do të kryejmë...

LIJE SHEHU:

Kam djalin këtu që do të niset për Afganistan, ai quhet Ilirjan Shehu. Këto ditë ai mbushi 26 vjeç dhe është beqar. Unë jam krenare që kam rrit një djalë trim, të shkathët dhe që vlerësohet. Por prapë malli mbetet mall. Mungesa e tij për disa kohë do ma mbushi shpirtin me mall. Jam e sigurt se do ta përfundojë detyrën me nder dhe Zoti do të jetë gjithmonë me të.

NËNTETAR BESMIR BASHA:


Jam shumë i emocionuar, por edhe i gëzuar, pasi shkoj në një mision të ri, specifik dhe sepse isha ndër të paktët që më zgjodhën. Një besim i madh që dua ta justifikoj. Unë jam bir ushtaraku dhe e di çdo të thotë detyrë, besoj se do e justifikojmë betimin dhe do ta përfundojmë me sukses këtë mision, këtë detyrë paqeje. Ndarja me të afërmit sigurisht nuk është e lehtë, por mendoj se malli të lidh më shumë me njerëzit, të lidh më shumë me atdheun. Faleminderit për besimin që më dhanë!

XHENISA HITA

Po përcjell bashkëshortin tim, Ervin Hita. Është një ditë e vështirë për mua, pasi jam shtatzënë, në muajin e shtatë dhe tani e doja më shumë se kurrë afër dorën e tij. Unë pres një djalë dhe ndoshta bashkëshorti nuk do të jetë në ditën e lindjes së tij. Jam shumë e emocionuar (lota), por edhe krenare pasi ai niset në një detyrë fisnike, për paqen. Zoti qoftë me të. Ne në çdo hap do të jemi pranë tij.

Ndahemi me këta djem të mrekullueshëm me urimin: kthehuni shëndoshë. Xhenisa, gruaja e re që pret një fëmijë, shikon të shoqin dhe barkun e saj. Diçka do të thotë, por lotët e ndalin fjalën. Ndoshta ai lot i buzëqeshur do të transmetojë fjalët: "Mos u mërzi, djalin do ta kem kujdes si sytë e ballit, si ëndërrën tënde të syve që merr në rrugën e misionit".

Mirukthefshi!
ALBERT ZHOLI



Fotot: Elvin Hasanaj